



Infrakos

# ***Ekspozeu i Rrjetit***



***Vlen nga data: 11.12.2016 - 09.12.2017***

**Tabela e modifikimeve  
të Ekspozeut të Rrjetit**

| <b>Numri</b> | <b>Data<br/>e hyrjes në fuqi</b> | <b>Numri i referencës<br/>së vendimit</b> | <b>Modifikimi<br/>në kapitullin</b> |
|--------------|----------------------------------|-------------------------------------------|-------------------------------------|
|              |                                  |                                           |                                     |
|              |                                  |                                           |                                     |
|              |                                  |                                           |                                     |
|              |                                  |                                           |                                     |
|              |                                  |                                           |                                     |
|              |                                  |                                           |                                     |
|              |                                  |                                           |                                     |
|              |                                  |                                           |                                     |
|              |                                  |                                           |                                     |
|              |                                  |                                           |                                     |
|              |                                  |                                           |                                     |

| <b>Përmbajtja</b>                   | <b>Faqe</b> |
|-------------------------------------|-------------|
| <b>1. Informatat e përgjithshme</b> | <b>3</b>    |
| <b>2. Kushtet e qasjes</b>          | <b>11</b>   |
| <b>3. Infrastruktura</b>            | <b>17</b>   |
| <b>4. Alokimi i kapaciteteve</b>    | <b>26</b>   |
| <b>5. Shërbimet</b>                 | <b>36</b>   |
| <b>6. Pagesat e qasjes</b>          | <b>44</b>   |
| <b>7. Shtojcat</b>                  | <b>57</b>   |

# 1. Informatë e përgjithshme ↑

## 1.1 Hyrje


Para 142 vitesh, gjegjësisht në vitin 1874 u ndërtua linja e parë hekurudhore në Kosovë në relacionin Hani i Elezit – Fushë Kosovë – Mitrovicë. Ishte ky fillimi i shtrirjes së rrjetit hekurudhor nëpër Kosovë, aq sa i rëndësishëm për transportin e udhëtarëve dhe mallrave, po aq i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe lidhjen e Kosovës me vendet e rajonit. Në vitin 1931 vazhdoi ndërtimi i kësaj linjës në relacionin Mitrovicë – Leshak, më 1934 ajo Fushë Kosovë – Prishtinë, më 1936 Fushë Kosovë – Pejë, më 1949 Prishtinë – Podujevë – Livadhi dhe më 1963 Klinë – Prizren. Kështu që sot Hekurudhat e Kosovës shtrihen në tërë territorin e Kosovës me një gjatësi prej 333,951 km linjë e hapur hekurudhore, me një gjatësi prej 105,784 km në stacione dhe 103,4 km linja industriale. Hekurudhat e Kosovës përmes Leshakut dhe Podujevës në veri dhe lindje janë të lidhura me Serbinë, ndërsa përmes Hanit të Elezit, në jug me Maqedoninë.

Me Ligjin mbi Hekurudhat në Republikën e Kosovës është paraparë që infrastruktura dhe operimi në Hekurudhat e Kosovës të jenë të ndara. Në bazë të ligjit mbi ndërmarrjet publike, Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA – INFRAKOS është kompani aksionare dhe të gjitha aksionet janë nën pronësinë e Qeverisë së Kosovës, në administrim të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Rrjeti hekurudhor i infrastrukturës hekurudhore në Kosovë është paraqitur në figurën në vijim:




Ndërsa në vijim është paraqitur struktura e zgjeruar organizative e sektorit hekurudhor në Kosovë sipas Ligjit mbi Hekurudhat në Republikën e Kosovës.





Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës sha, shkurtimisht INFRAKOS në bazë të organizimit ekzistues dhe në bazë të ligjit në fuqi është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe operimin me infrastrukturën hekurudhore. Struktura organizative e këtij sektori është paraqitur në organogramin vijues:



## 1.2 Qëllimi

Megenëse në bazë të ligjit është paraparë që të gjithë operatorëve hekurudhor të u lejohet qasja në rrjetin hekurudhor në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese, atëherë qëllimi i përpilimit të ekspozeut mbi rrjetin qëndron në atë që të gjithë operatorët hekurudhor të njihen me gjendjen ekzistuese të infrastrukturës hekurudhore dhe kushtet e shfrytëzimit të kësaj infrastrukture.

### 1.3 Baza ligjore

Operatorët hekurudhor gjatë kryerjes së transportit duhet të iu përmbahet të gjitha rregullave juridike, akteve dhe nën akteve ligjore nacionale.

### 1.4 Statusi ligjor

#### 1.4.1 Shënimet e përgjithshme

Menaxheri i Infrastrukturës të Hekurudhave të Kosovës ShA - INFRAKOS, bazuar në Ligjin për Hekurudhat në Republikën e Kosovës, është i obliguar të sjellë dhe publikon Ekspozeun e Rrjetit Hekurudhor të Infrastrukturës së Hekurudhave të Kosovës ShA - INFRAKOS.

Menaxheri i Infrastrukturës të Hekurudhave të Kosovës ShA. është i obliguar që Ekspozeun e Rrjetit hekurudhor rregullisht ta azhurnoj – rifreskoj dhe sipas nevojës edhe ta ndryshoj. Ekspozeu i Rrjetit hekurudhor publikohet më së voni katër muaj para afatit të fundit për paraqitjen e kërkesës për ndarjen e kapaciteteve të infrastrukturës, para hartimit të Orarit të ri vjetor për lëvizjen e trenave.

#### 1.4.2 Përgjegjësia

Ky Ekspoze mbi rrjetin është hartuar në bazë të informatave të njohura me datën 01.03.2016. Infrakos-i nuk përgjigjet për dëmet e shkaktuara të cilat janë si pasojë e gabimeve në shtypje të Ekspozeut të Rrjetit.

Në rast të jo përputhshmërisë të Ekspozeut për Rrjet me ligjet në fuqi, të vlefshme janë ligjet e aplikueshme në Kosovë. Ky Ekspoze për Rrjetin është hartuar duke u mbështetur në ligje të cila janë në aplikim në Kosovë. Të gjitha rregullat dhe dokumentet teknike të cilat do të hynë në fuqi pas publikimit të këtij Ekspozeu, duhet të aplikohen dhe duhet të merren parasysh gjatë interpretimit të Ekspozeut mbi Rrjetin.

Ekspozeu mbi Rrjetin publikohet edhe në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mos harmonizimit të versioneve shqip, serbisht dhe anglisht, vlen versioni i gjuhës shqipe.

#### 1.4.3 Procedura e ankimit

Operatorët e transportit hekurudhor mund të ankohen tek Autoriteti Rregullativ Hekurudhor (ARH), respektivisht Departamentit të Rregullimit të Tregut i cili është organ i ankesës për tregun hekurudhor, nëse ata besojnë se kanë qenë të trajtuar në mënyrë të padrejtë, të diskriminuar apo në ndonjë mënyrë tjetër të fyer, dhe në veçanti kundër vendimeve të miratuara nga INFRAKOS-i lidhur me:

- Ekspozeun e rrjetit dhe kriteret që përfshihen në të;
- Procesin e alokimit të traseve dhe rezultatin e tij;

- Skemën e pagesave për shfrytëzimin e infrastrukturës hekurudhore;
- Nivelin apo strukturën e pagesave të infrastrukturës që është apo që mund të kërkohej të paguhet;
- Aranzhimet për qasje në infrastrukturën hekurudhore;
- Aranzhimet për qasje dhe për pagesë për shërbimet;

## 1.5 Struktura e Ekspozeut mbi Rrjetin

Ky Ekspoze mbi Rrjetin është hartuar në harmoni me strukturën e Ekspozeut mbi Rrjetin (versioni 2006-03-30) i cili është aprovuar nga Organizata e Rrjetit Hekurudhor Evropian (Rail Net Europe), <http://www.rne.eu/>. Struktura e Ekspozeut mbi Rrjetin e aprovuar nga kjo organizatë, mundëson që ekspozetë mbi rrjetin të menaxherëve të ndryshëm të infrastrukturës të shteteve të ndryshme, të jenë identik dhe që të përmbajnë përafërsisht të njëjtat informata.

Struktura e Ekspozeut mbi Rrjetin përfshinë:

|                                 |                                                                                                                                |
|---------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1. Informacionet e përgjithshme | Përmban qëllimet e Ekspozeut mbi Rrjetin.                                                                                      |
| 2. Kushtet e qasjes             | Përcakton kushtet e qasjes të cilat operatorët e transportit duhet t'i plotësojnë për qasje në infrastrukturë.                 |
| 3. Infrastrukturën              | Përmban përshkrimin e infrastrukturës hekurudhore me të cilën menaxhon INFRAKOS-i.                                             |
| 4. Alokimin e kapaciteteve      | Përcakton procedurat e alokimit dhe kushtet e alokimit të kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore.                         |
| 5. Shërbimet                    | Përmban përshkrimin e shërbimeve të cilat i ofron INFRAKOS.                                                                    |
| 6. Pagesat                      | Përmban përshkrimin e metodave për llogaritjen e pagesave mbi shfrytëzimin e infrastrukturës hekurudhore dhe shërbimeve tjera. |

## 1.6 Kohëzgjatja e vlefshmërisë dhe mënyra e azhurnimit

### 1.6.1 Kohëzgjatja e vlefshmërisë

Kohëzgjatja e vlefshmërisë të Ekspozeut të Rrjetit është e lidhur me orarin vjetor të lëvizjes së trenave. Ky Ekspoze i Rrjetit do të vlen për OLT-në e vitit 2017 (prej 11.12.2016 - 09.12.2017), për shkak të kushteve ekzistuese specifike nga data e miratimit e deri në orarin e ri të trenave për vitin 2017.

Menaxheri i Infrastrukturës është i obliguar ta harton dhe publikon Ekspozenë mbi Rrjetin më së voni katër muaj para afatit të fundit për aplikim për ndarje të kapaciteteve të Infrastrukturës.



### 1.6.2 Mënyra e azhurnimit

Menaxheri i Infrastrukturës përmes ueb faqes [www.infrakos.com](http://www.infrakos.com) do t'i publikon ndërrimet dhe plotësimet eventuale të këtij Ekspozeu mbi Rrjetin.

### 1.7 Publikimi

Ekspozeu mbi Rrjetin publikohet në formë të shkruar dhe në formë elektronike në ueb faqen [www.infrakos.com](http://www.infrakos.com). Ekspozeu mbi rrjetin do të publikohet njëkohësisht në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

### 1.8 Kontaktet

Kontaktet brenda INFRAKOS-it lidhur me informatat rreth komunikacionit vendor dhe ndërkombëtar mund të merren te:

Departamenti për Komunikacion  
Z. Sabit Thaqi  
Tel. +381 38 550 550 132  
Mob. +386 49 222 137  
Email: [sabit.thaqi@kosovorailway.com](mailto:sabit.thaqi@kosovorailway.com)

### 1.9 Bashkëpunimi në mes të menaxherëve të infrastrukturës

Menaxherët e infrastrukturave hekurudhore, që në vitin 2004 e kanë formuar të ashtuquajturën organizatë RAILNET EUROPE në mënyrë që të unifikojnë punët rreth infrastrukturës hekurudhore të Evropës. Për më shumë shih ueb faqen <http://www.rne.eu/>.

#### 1.9.1 One Stop Shop (zona e përbashkët e menaxherëve të infrastrukturës)

Menaxherët e Infrastrukturës Evropiane kanë nënshkruar një marrëveshje mbi organizimin e shitjeve dhe marketingun e përbashkët për kapacitetin e infrastrukturës hekurudhore përmes RNE. Këta menaxherë të infrastrukturës kanë themeluar "One Stop Shop" të cilat do të funksionojnë si rrjet i pikave të kontaktit për klientë brenda kornizës së RNE-së. Për aplikime për trase ndërkombëtare, klienti duhet të kontaktoj vetëm njërën nga këto "One Stop Shop" e cila pastaj do të inicioj të gjithë procesin e alokimit të trasesë ndërkombëtare.

OSS-ja e kontaktuar në bashkëpunim të afërt me menaxherin përkatës do të:

- Ofroj përkrahje të klientit dhe informacione mbi prodhimet dhe shërbimet e menaxherëve të infrastrukturës;
- Merret me kërkesat për çfarëdo traseje të trenit ndërkombëtar brenda RNE-së;
- Siguroj që kërkesat për periudhën tjetër janë marrë parasysh në procesin e planifikimit kohor vjetor; dhe
- Japë oferta për trasetë e trenave për të gjitha udhëtimet ndërkombëtare.

Secila OSS është pjesë e rrjetit ndërkombëtar i cili ka për qëllim që qasjen në rrjet ta bëjë sa më të lehtë që është e mundur për klientë. OSS gjithashtu ofron edhe informacione në lidhje me pagesat e infrastrukturës dhe lëvizjet e trenave përfshirë këtu edhe monitorimin.

Sipas motos “one face to the customer” (një qasje e drejtë ndaj klientit), OSS ofron ndihmë kompetente dhe efikase nëpër të gjithë kufijtë, bazuar në procedura transparente, të besueshme dhe jo diskriminuese. Lista e kontakteve të OSS-ve mund të gjendet në [www.rne.eu](http://www.rne.eu).

Gjithashtu për herë të parë aplikantët e autorizuar (psh. portet të cilat dëshirojnë të sigurojnë kapacitet të mjaftueshëm hekurudhor) kanë shfrytëzuar mundësinë të vihen në kontakt direkt me menaxherët e infrastrukturës në lidhje me kërkesat për kapacitete dhe trasetë e trenave.

Në mënyrë që kjo të bëhet, RNE fokuson të gjithë procesin e prodhimit të infrastrukturës hekurudhore. Kjo fillon me harmonizimin e anëtarëve në lidhje me planet afatgjate dhe afatshkurta, qasjeve të marketingut dhe shitjeve të përbashkëta, planifikimit të duhur, operimit dhe përfundon me shërbimet pas shitjes nga ana e RNE-së, siç janë monitorimi dhe raportimi. Për të gjitha këto personi kontaktues i INFRAKOS-it është:

Departamenti i Komunikacionit të INFRAKOS-it  
Sheshi i Lirisë pn.  
12000 Fushë Kosovë  
Republika e Kosovës  
Personi kontaktues:  
Z. Sabit Thaqi  
Tel. +381 38 550 550 132  
Mob. +386 49 222 137  
Email: [sabit.thaqi@kosovorailway.com](mailto:sabit.thaqi@kosovorailway.com)

### 1.10 Shprehjet e përdorura

Shprehjet e përdorura në këtë Ekspoze të Rrjetit kanë kuptimet e definuar në ligjin mbi hekurudhat dhe atë:

|                            |                                                                                                                                                                                                                                                    |
|----------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Kërkesa “Ad hoc”           | Aplikimet për alokim të kapaciteteve të hekurudhës me të cilën kërkohet alokimi i një traseje të trenit jashtë procedurës së alokimit.                                                                                                             |
| One Stop Shop              | Përfaqësuesi i Menaxherit të Infrastrukturës i cili së bashku me përfaqësuesit e Menaxherëve të Infrastruktura të tjera lidhë rrjetin ndërkombëtar me të cilën shfrytëzuesve u mundëson më lehtë qasje në rrjetin e përbashkët të infrastrukturës. |
| Pathfinder                 | Ndërlidhjet ndërkombëtare të internetit për koordinim të traseve të trenave ndërkombëtar                                                                                                                                                           |
| Menaxher i Infrastrukturës | Personi juridik i autorizuar për menaxhim të Infrastrukturës hekurudhore                                                                                                                                                                           |

|                                          |                                                                                                                                                                                                                                |
|------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Trainkos dhe operatorët tjerë hekurudhor | Të gjithë personat juridik vendor dhe ndërkombëtar të cilët kanë leje për kryerjen e shërbimeve në transportin publik në hekurudhë dhe vendimin e sigurisë “Licencën” të lëshuar nga organi meritör.                           |
| Licenca për transport                    | Licenca për kryerjen e shërbimeve publike të cilën e lëshon Autoriteti Rregullativ Hekurudhor                                                                                                                                  |
| Certifikata për siguri në transport      | Certifikata e sigurisë për kryerjen e shërbimeve të transportit hekurudhor në pajtim me Rregulloren mbi kushtet dhe mënyrën e dhënies së certifikatës së sigurisë për kryerjen e shërbimeve publike në transportin hekurudhor. |

Shkurtesat të cilat përdorën në Ekspoze të Rrjetit:

|          |                                                                  |
|----------|------------------------------------------------------------------|
| MI       | Menaxheri i Infrastrukturës - INFRAKOS                           |
| OSS      | One Stop Shop                                                    |
| RNE      | Rail Net Europe (Rrjeti i Hekurudhave Evropiane)                 |
| OH       | Operatori Hekurudhor                                             |
| BE       | Bashkësia Evropiane                                              |
| EC       | Komisioni Evropian                                               |
| UIC      | Organizata Hekurudhore Ndërkombëtare                             |
| RID 2001 | Rregullore për transport ndërkombëtar të materieve të rrezikshme |
| OTIF     | Organizimi ndërshtetëror për transport hekurudhor                |
| COTIF    | Konventa ndërkombëtare për transport hekurudhor                  |



## ***2. Kushtet e qasjes ↑***

### **2.1 Hyrje**

Qasja në Infrastrukturën hekurudhore të Republikës së Kosovës është rregulluar me Ligjin për Hekurudhat në Republikën e Kosovës Nr. 04/L – 063 të miratuar më 14.11.2011 dhe të akteve nën ligjore të mbështetura në këtë ligj dhe aktet tjera të BE-së. Ky Ekspoze mbi Rrjetin i INFRAKOS-it shërben si udhërrëfyes për operatorët hekurudhor të cilët paraqesin aplikimet për ndarjen e kapaciteteve të infrastrukturës.

### **2.2 Kushtet e përgjithshme për qasje**

Menaxheri i Infrastrukturës të Hekurudhave të Kosovës ShA - INFRAKOS si administrues i infrastrukturës e lejon qasjen në infrastrukturën hekurudhore për të cilën Menaxheri i Infrastrukturës të Hekurudhave të Kosovës ShA dhe operatorët hekurudhor, lidhin kontratë për pagesat e qasjes. Kontrata për pagesat e qasjes rregullon marrëdhëniet, të drejtat, obligimet, saktëson kapacitetet e ndara, lartësinë e detyrimeve për shfrytëzimin e infrastrukturës hekurudhore dhe çështjet tjera në lidhje me garantimin e sigurisë së transportit dhe mbrojtjen e ambientit.

Menaxheri i Infrastrukturës të Hekurudhave të Kosovës ShA, lejon qasjen në infrastrukturën hekurudhore për të gjithë operatorët hekurudhor të cilët kanë licencë dhe certifikatë valide të sigurisë.

#### **2.2.1 Kushtet për paraqitjen e aplikimit për kapacitetet e infrastrukturës**

Aplikimin për ndarjen e kapaciteteve të infrastrukturës mund ta paraqes operatori hekurudhor i cili:

- Në kohën e paraqitjes së aplikimit është i regjistruar për kryerjen e shërbimeve të transportit hekurudhor;
- Ka të lëshuar licencën valide për ndërmarrjen hekurudhore të lëshuar nga autoriteti kompetent;
- Ka certifikatë të vlefshme të sigurisë të lëshuar nga autoriteti kompetent.

Ndërmarrjet hekurudhore gjatë paraqitjes së kërkesës për ndarjen e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore duhet të respektojë afatet e përcaktuara në kapitullin 4 të këtij Ekspozeu.

Me rastin e kërkesës për ndarjen e kapaciteteve të infrastrukturës të cilat nuk kalojnë vetëm nëpër një rrjet hekurudhor, menaxheri i infrastrukturës të cilit iu ka drejtuar një kërkesë e këtillë, mund të kërkojë kapacitetet e infrastrukturës prej menaxherëve tjerë të infrastrukturës.

### 2.2.2 Kujt i lejohet shfrytëzimi i rrjetit hekurudhor të Kosovës

Shfrytëzimin e rrjetit hekurudhor të INFRAKOS-it në Kosovë mund ta bëjnë të gjitha ndërmarrjet hekurudhore të cilat posedojnë licencën dhe certifikatën valide të sigurisë të lëshuar nga autoriteti kompetent dhe të aprovuar nga ARH-ja e Kosovës.

### 2.2.3 Licenca për kryerjen e shërbimeve publike në transportin hekurudhor

Lidhur me validitetin e licencës kontaktoni Departamentin Ligjor dhe të Licencimit të Autoritetit Rregullativ Hekurudhor:

Autoritetin Rregullativ Hekurudhor  
Organin Hekurudhor të Licencimit  
Rr. Rustem Statovci, 29  
10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel. +381 38 220 040  
Fax. +381 38 223 340  
[www.arh-ks.org](http://www.arh-ks.org)

### 2.2.4. Certifikata e sigurisë për kryerjen e shërbimeve në transportin hekurudhor

Lidhur me validitetin e Certifikatës së sigurisë kontaktoni Departamentin Ligjor dhe të Licencimit të Autoritetit Rregullativ:

Autoritetin Rregullativ Hekurudhor  
Departamenti për Sigurinë Hekurudhore  
Rr. Rustem Statovci, 29  
10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel. +381 38 220 040

Fax. +381 38 223 340

[www.arh-ks.org](http://www.arh-ks.org)

### 2.2.5 Sigurimi

Operatorët hekurudhor duhet të jenë të siguruar në mënyrë adekuate, apo në përputhje me ligjet kosovare dhe ndërkombëtare të bëjë aranzhime ekuivalente për të mbuluar përgjegjësinë e vet në rast të aksidenteve e në veçanti në lidhje me udhëtarët, bagazhin, mallrat, postën dhe palët e treta. Për informata tjera kontaktoni:

Autoritetin Rregullativ Hekurudhor  
Departamenti Ligjor dhe i Licencimit  
Rr. Rustem Statovci, 29  
10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel. +381 38 220 040  
Fax. +381 38 223 340  
[www.arh-ks.org](http://www.arh-ks.org)

### 2.3 Aplikimi për trase të trenit

Shih kapitullin 4 të këtij Ekspozeu mbi Rrjetin.

### 2.4 Kushtet e përgjithshme të biznesit

#### 2.4.1 Marrëveshja kornizë

Marrëveshja kornizë është ligjërish marrëveshje obligative me të cilën rregullohen të drejtat dhe obligimet të paraqitësit të kërkesës – aplikuesit për alokim - ndarje të kapaciteteve të Infrastrukturës dhe pronarit të Infrastrukturës për kohëzgjatje më të gjatë se të një orari të lëvizjes së trenave. Kjo marrëveshje konkretizohet me nënshkrimin e kontratës për qasje në binarë sipas nenit 76 të Ligjit mbi Hekurudhat Nr. 04/L-063.

INFRAKOS-i dhe aplikuesi mund të nënshkruajnë një marrëveshje kornizë me kusht që me këtë marrëveshje nuk ndërpritet paraprakisht shfrytëzimi i infrastrukturës përkatëse nga ana e aplikuesve të tjerë edhe për shërbime tjera.

#### 2.4.2 Kontratat për qasje në binarë

Kontrata për qasje është kontratë që lidhet në mes të Menaxherit të Infrastrukturës dhe Operatorit Hekurudhor sipas Nenit 72, paragrafit 4 të Ligjit mbi Hekurudhat Nr. 04/L-063. Me këtë rregullohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella me të cilën përcaktohen kapacitetet e qasjes, lartësia e obligimeve për shfrytëzim të kapaciteteve hekurudhore dhe çështjet tjera në lidhje me sigurinë në transport dhe mbrojtje të mjedisit.

Me kontratë për qasje, MI i lejon operatorit hekurudhor qasje në Infrastrukturën



hekurudhore. Kontrata për qasje do të nënshkruhet pas zbatimit të procedurës për ndarjen e kapaciteteve.

## 2.5 Rregulloret operative

Infrastruktura hekurudhore mund të shfrytëzohet në mënyrën e cila garanton siguri dhe rregullshmëri në lëvizjet e transportit hekurudhor. Operatori hekurudhor është i obliguar që t'i respekton të gjitha rregulloret për shfrytëzim të Infrastrukturës hekurudhore dhe lëvizjeve të sigurta në transportin hekurudhor, duke i përfshirë edhe ato të cilat i harton Menaxheri i Infrastrukturës.

Autoriteti kompetent bënë hartimin e nënakteve ligjore me të cilat rregullohen lëvizjet në komunikacionin hekurudhor në rrjetin e INFRAKOS-it.

Deri në prurjen dhe aprovimin e rregulloreve të reja, aplikohen rregulloret në fuqi të ish Hekurudhave të Kosovës dhe ato të INFRAKOS-it.

## 2.6 Transportet e jashtëzakonshme (veçanta)

Transportin e dërgesave të veçanta në komunikacionin vendor dhe ndërkombëtar, si edhe kushtet me të cilat ky transport mund të realizohet e lejon MI përkatëse. Transporti i dërgesave të veçanta është i rregulluar me Rregulloren për dërgesat e veçanta ( Rregullorja e HK nr. 20 dhe Udhëzimi 99).

Operatori hekurudhor në transportin ndërkombëtar është i obliguar t'i zbaton dispozitat e UIC-së dhe deklaratës 502 me të cilën janë rregulluar procedurat për lejimin e kërkesave për transportin e dërgesave të veçanta. Dërgesat e veçanta pranohen për transport vetëm nëse i kanë plotësuar kushtet e posaçme teknike dhe kushtet operative.

Informacionet detale për transportin e dërgesave të veçanta gjinden në kapitullin 4 dhe 5 të këtij Ekspozeu mbi Rrjetin. Kontakti për transport të dërgesave të veçanta:

INFRAKOS  
Departamenti për MLH  
Z. Nexhmi Rama  
Tel. +381 38 550 550 212  
Mob. +386 49 309 832  
Fax. + 381 38 550 550 222  
E-mal. [nexhmi.rama@kosovorailway.com](mailto:nexhmi.rama@kosovorailway.com)

## 2.7 Materiet e rrezikshme

Materie e rrezikshme janë ato mallra të cilat mund të rrezikojnë shëndetin e njeriut, të shkaktojnë ndotjen e mjedisit ose të shkaktojnë dëme materiale të cilat kanë veti të rrezikshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin dhe si të tilla janë qartësuar me ligje, rregulla tjera dhe me kontrata ndërkombëtare të cilat në bazë

të natyrës, vetive dhe gjendjes së tyre në lidhje me transportin mund të janë të rrezikshme për sigurinë publike, rendin ose që janë treguar toksike, brejtëse, shqetësuese, të ndezshme, shpërthyes ose radioaktive. Materie e rrezikshme konsiderohet edhe lënda e parë prej të cilës prodhohet materiet e rrezikshme dhe mbeturinat nëse kanë veti të materieve të rrezikshme.

Transporti i materieve të rrezikshme është rregulluar me Ligjin për transportin e materieve të rrezikshme (nr. 2004/6) i cili rregullon transportin e mallrave në transportin rrugor dhe hekurudhor. Për transportin e mallrave të rrezikshme në transportin hekurudhor zbatohet edhe Ligji për vërtetimin e Protokollit 03, dhe Rregullorja mbi transportin ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme me hekurudhë – RID 2001.

Informatat më të hollësishme për transportin e mallrave të rrezikshme mund të merren në pikat 4 dhe 5 të këtij Ekspozeu të Rrjetit hekurudhor.

Kontakti për transportin e mallrave të rrezikshme:

Departamenti i Komunikacionit të INFRAKOS-it  
Sheshi i Lirisë pn.  
12000 Fushë Kosovë  
Republika e Kosovës  
Personi kontaktues:  
Sabit Thaqi  
Tel. +381 38 550 550 132  
Mob. +386 49 222 137  
Email: [sabit.thaqi@kosovorailway.com](mailto:sabit.thaqi@kosovorailway.com)

## 2.8 Procedura e pranimi të mjeteve lëvizëse

Operatorët hekurudhor mund të shfrytëzojnë vetëm ato mjete lëvizëse të cilat i plotësojnë rregullat teknike dhe standardet të vlefshme në Kosovë.

Mjetet lëvizëse me konstruksionin e vet dhe gjendjen teknike duhet të sigurojnë komunikacion të sigurt, sigurinë e njerëzve, objekteve, të punësuarve dhe duhet t'i plotësojë kushtet teknike të linjave hekurudhore.

Mjetet lëvizëse të hekurudhave tjera mund të qarkullojnë në rrjetin hekurudhor të Kosovës nëse i plotësojnë kushtet e përcaktuara me marrëveshjet ndërkombëtare, rregullat ndërkombëtare dhe rregullat vendore.

Një ndër kushtet për marrjen e certifikatës së sigurisë për transport hekurudhor është që mjetet lëvizëse të cilat operatori hekurudhor mendon t'i shfrytëzon për realizim të transportit hekurudhor në Infrastrukturën hekurudhore të INFRAKOS-it t'i plotësojnë kushtet teknike dhe standardet e parapara me ligjin the aktet nënligjore për siguri në transportin hekurudhor. Është e nënkuptueshme se mjetet lëvizëse të operatorit hekurudhor i cili ka licencë dhe certifikatë të sigurisë të vlefshme për ofrimin e shërbimeve të transportit hekurudhor, i plotëson kushtet

e kërkuara. Operatori hekurudhor është përgjegjës për gjendjen e tyre teknike, mirëmbajtjen dhe punën e tyre.

Mjetet lëvizëse të cilat mund të qarkullojnë në rrjetin hekurudhor të Kosovës janë:

- Mjetet lëvizëse vendore të cilat posedojnë licencë për shfrytëzim të lëshuar sipas Ligjit mbi Hekurudhat,
- Mjetet lëvizëse të shteteve tjera ose operatorëve ndërkombëtar të cilat bartin shenjën RIV, RIC dhe TEN.

Lidhur me pranimin e mjeteve lëvizëse në rrjetin hekurudhor të INFRAKOS-it, kontaktoni Departamentin e Interoperabilitetit të Autoritetit Rregullativ Hekurudhor në adresën:

Autoritetit Rregullativ Hekurudhor  
Departamenti i Interoperabilitetit  
Rr. Rustem Statovci, 29  
10000 Prishtin[, Kosov[  
Tel. +381 38 220 040  
Fax. +381 38 223 340  
[www.arh-ks.org](http://www.arh-ks.org)

## 2.9 Procedura e pranimi të personelit

Njëri nga kushtet që operatori hekurudhor të fiton certifikatën e sigurisë për ofrimin e shërbimeve të transportit hekurudhor është që personeli të cilin operatori hekurudhor e ka të punësuar për operim dhe tërheqjen e trenave në ofrimin e shërbimeve të transportit, ka kompetencë profesionale dhe i plotëson kushtet mjekësore në përputhje me rregulloret dhe standardet e sigurisë. Është e kuptueshme që stafi i operatorit hekurudhor i cili ka licencë dhe certifikatë të të vlefshme sigurisë duhet t'i plotësojë kushtet e kërkuara.



### ***3. Infrastruktura e menaxhuar ↑ nga INFRAKOS-i***

#### **3.1 Hyrje**

Në këtë kapitull të Ekspozeut të Rrjetit është e përshkruar infrastruktura hekurudhore e cila gjendet në pronësi të Republikës së Kosovës të cilën e menaxhon INFRAKOS-i.

Informatat mbi infrastrukturën hekurudhore janë prezantuar në këtë Ekspoze të Rrjetit bazuar në dukuritë të cilat kanë qenë të njohura në momentin e hartimit të Ekspozeut të Rrjetit. Të gjitha ndryshimet të cilat paraqiten pas hartimit do të azhurnohen në ueb faqen: [www.infrakos.com](http://www.infrakos.com).

Për kapacitetet e infrastrukturës të cilat nuk menaxhohen nga INFRAKOS-i do të jepen adresat kontaktuese ku mund të merren informata shtesë për mundësinë e shfrytëzimit.

### 3.2 Dimensionet e rrjetit

Hekurudhat e Kosovës disponojnë me 347.741 km gjatësi ndërtimore të linjave hekurudhore një binarëshe. Harta e rrjetit hekurudhor është paraqitur në shtojcën në fund të këtij Ekspozeu të rrjetit.

#### 3.2.1 Kufijtë

Republika e Kosovës disponon me një rrjet hekurudhor që menaxhohet nga INFRAKOS-i në emër të pronarit – Qeverisë të Republikës së Kosovës. Me kufij nënkuptojmë kufijtë shtetëror si dhe kufijtë me infrastrukturën e hekurudhave fqinje.

Te kalimi i kufijve shtetëror nuk ka ndryshime të gjerësisë së binarit.

#### 3.2.2 Lidhja e rrjetit hekurudhor

Rrjeti i Hekurudhave të Kosovës është i lidhur me dy shtete: Republikën e Serbisë dhe Republikën e Maqedonisë.

#### Pasqyra e kalimeve kufitare:

| Kalimi kufitar kodet | Emërtimi i kalimit kufitar | Kalimi kufitar mes shteteve | Shteti fqinjë | Drejtimi                     |
|----------------------|----------------------------|-----------------------------|---------------|------------------------------|
| 1                    | 2                          | 3                           | 4             | 5                            |
| 0                    | Leshak                     | Kosovë/Serbi                | Serbi         | Në veri                      |
| 0                    | Hani i Elezit              | Kosovë/Maqedoni             | Maqedoni      | Në jug                       |
| 0                    | Merdarë                    | Kosovë/Serbi                | Serbi         | Në lindje. Jashtë përdorimit |

Përgjatë rrjetit hekurudhorë ekziston edhe një numër i binarëve industrial, pronë e kompanive publike dhe private.

#### 3.2.3 Informatat plotësuese

Informatat plotësuese për Infrastrukturën hekurudhore, të cilat MI nuk i ka përfshi në këtë përshkrim mund të merren në këtë adresë:

Z. Nexhmi Rama  
 Departamenti për MLH  
 12000 Fushë Kosovë  
 Tel. +381 38 550 550 212  
 Mob. +386 49 309 832  
 Fax. + 381 38 550 550 222  
 E-mal. [nexhmi.rama@kosovorailway.com](mailto:nexhmi.rama@kosovorailway.com)

### 3.3 Përshkrimi i hekurudhës

#### 3.3.1 Identifikimi gjeografik

##### 3.3.1.1 Lloji i linjave hekurudhore

Rrjeti hekurudhor përbëhet prej linjave hekurudhore një binarëshe me një gjatësi prej 333.942 km.

Në këtë gjatësi nuk janë të përfshirë binarët e stacioneve dhe binarët industrial. Vërejtje: Llojet e linjave hekurudhore janë paraqitur në shtojcën “kategorizimi i linjave”.

##### 3.3.1.2 Gjerësia e binarit

Gjerësia e binarit është 1435 mm (normale) në tërë rrjetin hekurudhor.

##### 3.3.1.3 Stacionet dhe nyjet hekurudhore

Stacionet dhe nyjet hekurudhore janë:

- Emërtimi i stacioneve dhe vendeve zyrtare është përfshirë në shtojcën nr. 1.1
- Largësia në mes të stacioneve është paraqitur në metra në shtojcën nr 1.1
- Pasqyra e gjatësisë së trenave në varshmëri nga gjatësia e binarëve në stacione është paraqitur në shtojcën nr. 1.2.

#### 3.3.2 Karakteristikat e infrastrukturës

##### 3.3.2.1 Profili i lirë

Profili është hapësirë e lirë e cila mundëson kalimin e trenave. Dimensionet e profilit të lirë janë valide për hekurudha në drejtim dhe kthesë  $R \geq 250$  m. dhe dallohen me sa vijon:

- profili ngarkues me dimensione 3150/4650 mm
- profili i lirë me dimensione 4000/4800 mm. Këto dimensione duhet ruajtur gjatë mirëmbajtjes dhe ndërtimit të hekurudhave. Dimensionet dhe skemën grafike mund ta shihni në shtojcën “Profili Ngarkues”.

##### 3.3.2.2 Shtypja boshtore e lejuar

Limitet e masës që aplikohen në Hekurudhat e Republikës së Kosovës janë si në vijim:

- Linja hekurudhore Leshak-Fushë Kosovë-Hani i Elezit me shtypjen boshtore 22.5 ton/bosht dhe shtypjen gjatësore 7.2 ton/m.

- Linja hekurudhore Fushë Kosovë-Pejë me shtypjen boshtore 20.0 ton/bosht dhe shtypje gjatësore 6.4 ton/m.
- Linja hekurudhore Klinë-Prizren me shtypjen boshtore deri në Mirushë km 13+800 është 22.5 ton/bosht dhe shtypje gjatësore 7.2 ton/m. Kurse prej km 13+800 deri në Prizren me shtypje boshtore 18.0 ton/bosht dhe shtypje gjatësore 5.00 ton/m.
- Linja hekurudhore Fushë Kosovë-Bardhosh-Livadh me shtypja boshtore deri në Bardhosh 22.5 ton/bosht dhe shtypje gjatësore 7.2 ton/m. Kurse prej stacionit Bardhosh - Livadhi me shtypje boshtore 16.0 ton/bosht dhe shtypje gjatësore 5.00 ton/m. Shih shtojcën nr. 1.4.

### 3.3.2.3 Pjerrtësia dhe rezistenca përkatëse

Pjerrtësitë dhe rezistencat maksimale - ekzistuese në hekurudhat e Republikës së Kosovës janë të prezantuara në: Shtojcën nr. 1.3

### 3.3.2.4 Shpejtësitë

Shpejtësitë maksimale të lejuara në rrjetin hekurudhorë të Kosovës janë si në vijim:

- Linja hekurudhore Leshak - Fushë Kosovë, me shpejtësi maksimale 60 km/h.
- Linja hekurudhore Fushë Kosovë - Gurëz me shpejtësi maksimale 70 km/h.
- Linja hekurudhore Gurëz – Hani i Elezit me shpejtësi maksimale 60 km/h.
- Linja hekurudhore Fushë Kosovë - Klinë me shpejtësi maksimale 60 km/h.
- Linja hekurudhore Klinë - Pejë me shpejtësi maksimale 70 km/h
- Linja hekurudhore Klinë-Prizren me shpejtësi maksimale (Klina-km 13+800 me 30 km/h dhe Km 13+800 - Xërxe 20 km/h).
- Linja hekurudhore Fushë Kosovë-Prishtinë me shpejtësi maksimale 50 km/h; dhe
- Linja hekurudhore Prishtinë-Bardhosh me 30 km/h.

### 3.3.2.5 Gjatësia e trenave

Gjatësia e çdo treni përcaktohet në procedurë të alokimit të kapaciteteve. Shih shtojcën 1.2.

### 3.3.2.6 Linjat e elektrifikuara

INFRAKOS nuk ka linja hekurudhore të elektrifikuara.

### 3.3.3 Sistemi i kontrollit të trafikut CTC

Në INFRAKOS gjatë vitit 2006 është instaluar sistemi i kontrollit të komunikacionit në linjën kryesore Hani i Elezit-Leshak 154 km ku në panelin e kontrollit në sallën qendre të CTC-së në Fushë Kosovë, për momentin janë nën



kontroll 11 stacione, respektivisht linja (Mitrovicë – Hani i Elezit). Sistemi i kontrollit të komunikacionit është i teknologjisë së re informative i tipit TRIS CTC. Përmes këtij sistemi të CTC-së, stacioni kontrollohet dhe komandohet nga salla qendrore në Fushë Kosovë dhe përmes indikacioneve në panel kemi informatat mbi gjendjen e stacioneve.

### **3.3.3.1 Sistemet e Sinjalizimit**

Në rrjetin hekurudhor është i instaluar sistemi i sinjalizimit për sigurimin e stacioneve me pajisje sinjalo-siguruese elektroreleike të tipit Energoinvest - Ericsson. Me këtë sistem janë të siguruara 14 stacione në linjën kryesore Hani i Elezit-Leshak. Me tip-elektroreleik të këtij sistemi Energoinvest - Ericsson janë të siguruara 19 vendkalime në linjën Hani i Elezit - Leshak. Me pajisje elektronike janë të siguruara 4 vendkalime në linjën Fushë Kosovë-Pejë ( tipi-Scheidt & Bachmann). Me këtë sistem të sinjalizimit sigurohet stacioni dhe çdo formim i rrugëudhëtimeve është i kushtëzuar me pozitën e ndërrueses, domethënien e sinjalit, gjendjen e vendkalimit, gjendjen e brezit izolues dhe kushteve tjera të sigurisë në komunikacion. (Shih shtojcën – Rrjeti dhe mënyra e sigurimit të stacioneve).

### **3.3.3.2 Sistemi i kontrollit të komunikacionit**

Kjo është e përfshirë në pikën 3.3.3 – përshkrimi për CTC-në.

### **3.3.3.3 Sistemi i komunikimit**

Në rrjetin hekurudhorë si mjete të komunikimit tani përdoren lidhjet telefonike të realizuara përmes fijeve të kablllove optik dhe pajisjet e radio-lidhjeve. Bisedat e zhvilluara përmes radio-lidhjeve nga tërë rrjeti hekurudhor dhe bisedat telefonike në tërë rrjetin hekurudhor incizohen në regjistrofonin 16 kanalësh tipi MARATHON COMPACT Digital Voice Recorder. (Shih shtojcën – Rrjeti i radio komunikimit).

### **3.3.3.4 Sistemi i kontrollit të trenave**

Në rrjetin hekurudhor në linjën kryesore është i instaluar sistemi “Iskra” i cili mundëson dirigjimin dhe kontrollin e lëvizjes së trenave nga pulsi qendror në Fushë Kosovë (CTC).

## **3.4 Kufizimet për lëvizjen e trenave**

### **3.4.1 Linjat e specializuara**

Rrjeti Hekurudhorë i Kosovës nuk posedon linja të specializuara.

### **3.4.2 Kufizimet ambientale**

Në Rrjetin Hekurudhor të Kosovës do të zbatohen ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

### 3.4.3 Ngarkesat e rrezikshme

Në Rrjetin Hekurudhor të Kosovës nuk ekzistojnë linja të cilat e ndalojnë transportin e mallrave të rrezikshme.

Mallrat e regjistruara si të rrezikshme në linjat e Infrastrukturës së Hekurudhave të Kosovës mund të transportohen nën monitorimin e transportit dhe me lejim paraprak në përputhshmëri me rrezikshmërinë. Për informata shtesë mund të kontaktoni:

INFRAKOS-in  
Z. Sabit Thaqi  
Tel. +381 38 550 550 132  
Mob. +386 49 222 137  
Email: [sabit.thaqi@kosovorailway.com](mailto:sabit.thaqi@kosovorailway.com)

### 3.4.4 Kufizimet nëpër tunele

Përgjatë rrjetit hekurudhorë ekzistojnë këto tunele sipas linjave:

- Linja hekurudhore Leshak-Fushë Kosovë-Hani i Elezit me 14 tunele me gjatësi totale 2947 m.
- Linja hekurudhore Fushë Kosovë-Pejë me 6 tunele me gjatësi totale 2423 m.
- Linja hekurudhore Klinë-Prizren me 2 tunele me gjatësi totale 738 m.
- Linja hekurudhore Fushë Kosovë-Bardhosh-Livadhi me 2 tunele me gjatësi totale 3275 m.

Numri total i tuneleve është 24 me gjatësi totale 9392 m.

Transportet e ngarkuara në suaza të profilit ngarkues nuk paraqesin kufizime nëpër tunele për shkak të gabaritit.

Kufizimet nëpër tunele për shkak të gjendjes teknike janë si vijon:

|   |                                    |         |         |         |
|---|------------------------------------|---------|---------|---------|
| 1 | Gurëz - Kaçanik (Runjevë)          | 297+223 | 297+374 | 20 km/h |
| 2 | Kaçanik- H. Elezit (Guri i shpuar) | 301+730 | 301+882 | 20 km/h |
| 3 | Kaçanik- H. Elezit (Gajre)         | 302+456 | 302+654 | 60 km/h |
| 4 | Kaçanik- H. Elezit ( Valan)        | 307+032 | 307+295 | 20 km/h |
| 5 | Kaçanik- H. Elezit ( VII)          | 307+472 | 307+598 | 20 km/h |

### 3.4.5 Kufizimet nëpër ura

Përgjatë rrjetit hekurudhorë ekzistojnë këto ura të ndërtuara prej çeliku, betoni dhe të gurit, bazuar sipas linjave në vijim:

- Linja hekurudhore Leshak-Fushë Kosovë-Hani i Elezit me 56 ura të çelikut dhe 21 ura të betonit.
- Linja hekurudhore Fushë Kosovë-Pejë me 8 ura të çelikut, 10 ura të betonit dhe 4 ura të gurit.
- Linja hekurudhore Klinë-Prizren me 12 ura të betonit.
- Linja hekurudhore Fushë Kosovë-Bardhosh-Livadhi me 4 ura të çelikut dhe 3 ura të betonit.

Numri total i urave është 118 me gjatësi totale 2988 m. Transportet e ngarkuara në suaza të profilave ngarkues, shtypjes boshtore dhe gjatësore nuk paraqesin kufizime të transportit nëpër ura. Kufizime prej erërave dhe hapjeve nuk ka.

### 3.5 Disponueshmëria e Infrastrukturës

Të gjitha linjat hekurudhore në Menaxhim të MI janë të hapura për transport të përgjithshëm prej orës 0 - 24. Këtu bëjnë pjesë të gjitha linjat hekurudhore të potencuara në shtojcën 1.5.

Në linjat hekurudhore në të cilat punohet me orar të kufizuar pune, lëvizja e trenave mund të realizohet përjashtimisht edhe në kohën e kufizimit të atyre stacioneve.

Menaxheri i Infrastrukturës është përgjegjës për mirëmbajtjen, rikonstruimin dhe përmirësimin e infrastrukturës ashtu që me siguri adekuate ta ofron realizimin e shërbimeve. Me këtë qëllim MI planifikon mirëmbajtje të rregullt të linjave hekurudhore e cila ka ndikim në kapacitetet e infrastrukturës, në kuptimin e mbylljes së segmenteve të linjave hekurudhore në kohë të caktuar si dhe shpejtësive të kufizuara përkohësisht.

Kufizimet në Infrastrukturë për mirëmbajtje të rregullt publikohen në Librezën e OLT-së.

MI një muaj më herët i lajmëron operatorët hekurudhor për të gjitha punimet më të gjata të cilat mund të ndikojnë në realizimin e transportit. Këtu përfshihet zvogëlimi i shpejtësive, vonesat e trenave dhe zëvendësimi i trenave me autobusë.

### 3.6 Stacionet për pranimin dhe përcjelljen e udhëtarëve

Pasqyra e stacioneve dhe vend qëndrimeve të hapura për pranim dhe përcjellje të udhëtarëve gjendet në shtojcën 1.6

### 3.7 Terminalët e mallrave

Me termin “terminali i mallrave” në rrjetin hekurudhor me të cilin menaxhon MI nënkuptohen të gjitha stacionet hekurudhore të hapura për pranim dhe përcjellje të mallrave në të cilat kryhet ngarkim-shkarkimi dhe ringarkimi i mallrave.

Për këtë qellim dallojmë:

- Stacionet (terminalet konvencionale)
- Terminalet për transporte intramodale

Pasqyra e të gjitha stacioneve të hapura për punë me mallra gjenden në shtojcën 1.6

### 3.8 Pajisjet shërbyese

#### 3.8.1 Stacionet për formim të trenave

Stacionet për formimin e trenave të mallrave janë vende në të cilat formohen dhe shformohen trenat.

Formimi i trenave kryesisht kryhet në këto stacione: Miradi, Hani Elezit, Pejë dhe Drenas.

Funksionin primar për formimin e trenave e ka stacioni hekurudhor Miradi. Stacioni është i kompletuar me binarë të mjaftueshëm për formimin dhe shformimin e trenave.

Informatat detale për gjatësinë maksimale të trenave të cilët formohen mund t'i merrni në këtë adresë:

INFRAKOS  
Z. Ukë Shala  
Sektori i Komunikacionit  
Fushë Kosovë  
Tel. +381 38 550 550 180;  
Mob. +386 49 379 008  
e-mail: [uke.shala@kosovorailway.com](mailto:uke.shala@kosovorailway.com)

Stacionet për formimin e trenave të udhëtarëve përpos stacionit të Fushë Kosovës mund të jenë edhe të gjitha stacionet tjera të zotëruara me personel. Informatat detale për gjatësinë maksimale të trenave të cilët formohen në stacionet përkatëse mund t'i merrni në këtë adresë:

INFRAKOS  
Z. Ukë Shala  
Sektori i Komunikacionit  
Fushë Kosovë  
Tel. +381 38 550 550 180;  
Mob. +386 49 379 008  
e-mail: [uke.shala@kosovorailway.com](mailto:uke.shala@kosovorailway.com)

#### 3.8.2 Binarët për parkim

Parkimi i garniturave klasike bëhet në stacionin e Fushë Kosovës, stacionin e Pejës dhe stacionin e Hanit të Elezit në binar të përcaktuar për këtë qëllim.

Parkimi i garniturave motorike dhe lokomotivave bëhet në depon e tërheqjes së trenave.

Parkimi i vagonëve të mallrave zakonisht bëhet në binarët e posaçëm në stacionet e mëdha .

Informatat detale për binarët e paraparë për parkim të vagonëve mund t'i merrni në adresën:

INFRAKOS  
Z. Ukë Shala  
Sektori i Komunikacionit  
Fushë Kosovë  
Tel. +381 38 550 550 180;  
Mob. +386 49 379 008  
e-mail: [uke.shala@kosovorailway.com](mailto:uke.shala@kosovorailway.com)

### 3.8.3 Pajisjet e mirëmbajtjes së mjeteve lëvizëse

Mi për momentin nuk ofron shërbime për mirëmbajtje të mjeteve lëvizëse .

### 3.8.4 Pajisjet për furnizim me karburante

INFRAKOS-i për momentin nuk ofron shërbime për furnizim me karburante por kjo mund të bëhet nëse kërkohet dhe kontraktohet nga operatorët hekurudhor.

### 3.8.5 Pajisjet teknike

Menaxheri i Infrastrukturës hekurudhore nuk ofron shërbime për pajisje teknike.


### 3.8.6 Pajisjet tjera

#### 3.8.6.1 Rampa për ngarkim dhe shkarkim të mallrave

Pasqyra e rampave për ngarkim dhe shkarkim mallrave gjendet në shtojcën 1.6

## 3.9 Zhvillimi i Infrastrukturës

Infrastruktura hekurudhore në mënyrë permanente riparohet dhe modernizohet ashtu që të rritet kualiteti i shërbimeve dhe i kapaciteteve.



## 4. Alokimi i kapaciteteve ↑

### 4.1 Hyrje

Sipas Ligjit për Hekurudha, INFRAKOS-i është përgjegjës për alokimin e kapaciteteve të infrastrukturës për nevoja të transportit vendor dhe ndërkombëtar në mënyrë transparente dhe jo diskriminuese nëse paraprakisht janë plotësuar të gjitha dispozitat ligjore për kushtet e alokimit në Infrastrukturën hekurudhore të definuar në Kapitullin 2.

### 4.2 Përshkrimi i procedurës

Alokimi i kapaciteteve të Infrastrukturës në formë të trasesë kryhet sipas procedurave të parapara në këtë dokument për:

- Procedurat e alokimit të kapaciteteve të Infrastrukturës për orar vjetor të trenave;
- Procedurat e alokimit të kapaciteteve të Infrastrukturës, jashtë procedurës së hartimit të OLT-së vjetore ( duke i përfshirë porositë ad hoc)

#### 4.2.1 Si të paraqitet porosia (aplikimi)

Aplikimet për alokim të kapaciteteve të Infrastrukturës hekurudhore, operatorët e paraqesin në formularin për porosi të trasesë së trenit i cili gjendet në shtojcën

nr. 2.1 e cila është e publikuar në ueb faqen e INFRAKOS-it [www.infrakos.com](http://www.infrakos.com)

Kërkesat – aplikimet paraqiten sipas procedurave të definuara në shtojcën 2.1 të Ekspozeut të Rrjetit.

Në kërkesë kërkohet që të shënohen edhe këto të dhëna:

1. Emri i Operatorit Hekurudhor;
2. Lloji i trenit (i udhëtarëve, i mallrave, garniturë e zbrazët, tren vetëm lokomotivë, etj);
3. Koha e dëshiruar e nisjes/arritjes;
4. Ndalesat e nevojshme me kohën minimale të qëndrimit;
5. Periudha dhe ditët e lëvizjes;
6. Lloji dhe numri i vagonëve;
7. Gjatësia dhe masa e trenit (metra, ton);
8. Lloji dhe numri serik i lokomotivës;
9. Lokomotivat shtesë ( prapashtesë);
10. Shpejtësia maksimale e trenit;
11. Lloji i frenimit;
12. Të dhënat e posaçme siç janë manovrimi, ndërrimi i përbërjes, ndryshimi i personelit, mallra të rrezikshme, mënyra e pranim dorëzimit, formimi i trenave etj.

Të gjitha shënimet që mungojnë, operatori hekurudhor është i obliguar që në kërkesë të INFRAKOS-it t'i dërgon në afat prej 5 ditëve. Në të kundërtën nënkuptohet që kërkesa për aplikim të kapaciteteve nuk është dorëzuar.

#### 4.2.2 Mënyra e alokimit të kapaciteteve

INFRAKOS-i vendosë për alokimin e kapaciteteve duke i marr parasysh të gjitha kërkesat të cilat kanë arritur me kohë dhe me shënime të plota sipas dispozitave ligjore të cilat janë në fuqi.

Definimet e procedurave dhe afateve në procedurë të alokimit të kapaciteteve për trasetë ndërkombëtare, INFRAKOS-i i ka harmonizuar me RailNeEurope (Doracak mbi proceduat e alokimit të traseve të trenave në komunikacionin ndërkombëtar) i cili është i paraqitur në ueb faqen ([www.infrakos.com](http://www.infrakos.com)).

#### 4.2.3 Organet kompetente të përfshira në procedurë të alokimit dhe përgjegjësia e tyre

- INFRAKOS – s si organ kompetent i alokimit të kapaciteteve;
- Operatorët hekurudhor të cilët paraqesin kërkesat për alokim të kapaciteteve;
- RNE (RailNetEurope) si organ i cili koordinon alokimin e kapaciteteve në komunikacionin ndërkombëtar.



- FTE - Forum Train Europe - Organizata evropiane e operatorëve hekurudhor të cilën e përfaqësojnë forumin Evropian për planifikimin teknik të transportit të udhëtarëve dhe mallrave.

INFRAKOS-i akoma nuk është anëtar i RNE-së dhe FTE-së, por e ka statusin e vëzhguesit.

#### 4.3 Plani i dorëzimit të kërkesës për alokim të kapaciteteve dhe procedura e alokimit

Për çdo vit INFRAKOS-i e harton planin e dorëzimit të kërkesave për alokim të kapaciteteve i cili përdoret në procedurë të hartimit të orarit vjetor të trenave dhe në procedurë të alokimit të kapaciteteve jashtë procedurës të hartimit të orarit vjetor të trenave, duke i kyçur edhe kërkesat ad hoc të cilat publikohen në Ekspozeun mbi Rrjetin.

##### 4.3.1 Plani i dorëzimit të kërkesave për alokim të kapaciteteve për orar vjetor të trenave.

Kërkesat e ndërmarrjeve hekurudhore për alokim të kapaciteteve për Orar Vjetor të Lëvizjes së Trenave paraqiten në formularin e paraparë sipas afateve të përcaktuara, në këtë adresë:

Departamenti i Komunikacionit të INFRAKOS-it  
Sheshi i Lirisë pn.  
12000 Fushë Kosovë  
Republika e Kosovës  
Personi kontaktues:  
Z. Ukë Shala  
Sektori i Komunikacionit  
Fushë Kosovë  
Tel. +381 38 550 550 180;  
Mob. +386 49 379 008  
e-mail: [uke.shala@kosovorailway.com](mailto:uke.shala@kosovorailway.com)

Afatet për dorëzim të kërkesave dhe alokim të kapaciteteve për OLT 2013/2015 i cili fillon me 08.12.2013 dhe vlen deri me 14.12. 2015 gjenden në shtojcë 3.1.

##### 4.3.2 Plani i dorëzimit të kërkesave për alokim të kapaciteteve jashtë procedurës së hartimit të OLT-së vjetore

Për nevoja të ndërmarrjeve hekurudhore për alokim të kapaciteteve shtesë ose ndërrimin e traseve të alokuara, INFRAKOS-i e mundëson alokimin si më poshtë në këtë adresë:

Departamenti i Komunikacionit të INFRAKOS-it  
Sheshi i Lirisë pn.  
12000 Fushë Kosovë

Republika e Kosovës  
Personi kontaktues:  
Z. Ukë Shala  
Sektori i Komunikacionit  
Fushë Kosovë  
Tel. +381 38 550 550 180;  
Mob. +386 49 379 008  
e-mail: [uke.shala@kosovorailway.com](mailto:uke.shala@kosovorailway.com)

#### 4.4 Procedura e alokimit të kapaciteteve

Pasi që të ketë kaluar afati për dorëzim të kërkesës për hartim të OLT-së vjetore, INFRAKOS-i fillon me alokimin e kapaciteteve në mënyrë transparente dhe jo diskriminuese. Kërkesat e pranuar pas afatit të fundit për dorëzim nuk do të merren në shqyrtim.

Kërkesat për alokim të kapaciteteve të pranuar pas mbarimit të hartimit të projektit të OLT-së vjetore nuk mund të ndikojnë në ndryshim të projektit, përveç me pëlqim të ndërmarrjes hekurudhore të cilës paraprakisht i është alokuar kapaciteti.

Kapacitetet e alokuara mund të shfrytëzohen pas nënshkrimit të kontratës - marrëveshjes për qasje në mes të INFRAKOS-it dhe ndërmarrjes hekurudhore e cila ka paraqitur kërkesën për alokim të kapaciteteve.

Kapacitetet e alokuara nuk mund të barten te ndonjë ndërmarrje tjetër hekurudhore.

##### 4.4.1 Procedura e koordinimit

INFRAKOS për çdo vit në fillim të hartimit të OLT-së së re duhet të konsultohet me ndërmarrjet hekurudhore për planet e tyre të orarit i cili do të hyn në aplikim pas 11 muajve (x-11). Në periudhën e konsultimeve, INFRAKOS do t'i informon operatorët hekurudhor për mirëmbajtjen dhe punët tjera me rëndësi në Infrastrukturën hekurudhore.

Procedurën e koordinimit, punët e kyçes në infrastrukturë të cilat definojnë OLT-në vjetore, si dhe përgatitjet për nevoja të materialit punues e udhëheq INFRAKOS-i.

Pasi që të ketë kaluar afati i fundit për dorëzim të kërkesave për alokim të kapaciteteve për Orar Vjetor të Trenave, punët e alokimit në Infrastrukturë fillojnë me procedurën e koordinimit s' bashku me operatorët hekurudhor me qëllim të harmonizimit të kërkesave të pa definuara dhe harmonizimit të tyre me qëllim që sa më shumë të plotësohen dëshirat dhe kërkesat e operatorëve hekurudhor në mënyrë transparente dhe jo diskriminuese. Planifikimi i OLT-së përfshinë studimin e të gjitha kërkesave të arritura duke i përfshirë të gjitha kufizimet e planifikuara nga INFRAKOS-i për mirëmbajtje të Infrastrukturës.

Nëse numri i kërkesave për alokim të njëjtit kapacitet të Infrastrukturës tejkalon kapacitetet e linjës, Menaxheri i Infrastrukturës do t'i përdor rregullat e prioritetit të cekura në pikën 4.4.3.

Pasi që të kryhet procedura e koordinimit, INFRAKOS-i ua dërgon projektin e OLT-së ndërmarrjeve hekurudhore të cilat duhet të përgjigjen në mënyrë të shkruar për pranim të pjesshëm ose të plotë, apo për mospranim të OLT-së. Afati i përgjigjes është një muaj nga data e dorëzimit të projektit.

#### 4.4. 2 Procedura e zgjedhjes së kontesteve

Procedurat e zgjidhjes së kontesteve për asetet e infrastrukturës fillojnë me paraqitjen e vërejtjeve të shkruara nga ana e Operatorit Hekurudhor lidhur me pranimin/mospranimin e plotë ose të pjesshëm të OLT-së.

Ankesa së pari duhet t'i drejtohet INFRAKOS-it në adresën:

Departamenti i Komunikacionit të INFRAKOS-it  
Sheshi i Lirisë pn.  
12000 Fushë Kosovë  
Republika e Kosovës  
Personi kontaktues:  
Sabit Thaqi  
Tel. +381 38 550 550 132  
Mob. +386 49 222 137  
Email: [sabit.thaqi@kosovorailway.com](mailto:sabit.thaqi@kosovorailway.com)

Nëse nuk mund të gjendet zgjidhje, atëherë aplikanti mund të bënë ankimin në Autoritetin Rregullativ Hekurudhor në adresën:

Autoritetin Rregullativ Hekurudhor  
Organi për rregullimin e Tregut  
Rr. Rustem Statovci, 29  
10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel. +381 38 220 040  
Fax. +381 38 223 340  
[www.arh-ks.org](http://www.arh-ks.org)

#### 4.4.3 Infrastruktura e mbingarkuar. Definicioni, procesi dhe kriteri i prioritetit

Nëse për arsye të mbingarkesës së kapaciteteve, INFRAKOS-i në procedurën e koordinimit nuk mund t'i përfshinë të gjitha kërkesat e operatorëve hekurudhor, INFRAKOS-i do të kërkon që kapacitetet hekurudhore t'i proklamoni si të “mbingarkuara” dhe për këtë ta Informoni Autoritetin Rregullativ.

Në rastet kur INFRAKOS-i e proklamoni “mbingarkesën” e Infrastrukturës, e bënë analizën e kapaciteteve në infrastrukturën e mbingarkuar dhe i definoni kufizimet

për të cilat s'ka pasur mundësi që të plotësohen kërkesat për alokimi të kapaciteteve, atëherë ai duhet të propozon planin për përmirësimin e kapaciteteve të caktuara.

Kapacitetet e Infrastrukturës nuk mund të kuptohen si të mbingarkuara në këto raste:

- nëse nevoja për kapacitetet e përmendura nuk kalon 9 muaj dhe nëse nuk parashihet se kapacitetet e përmendura rishtazi do të kërkojnë;
- kur kapacitetet e infrastrukturës nuk mund të alokohen për shkak të kryerjes së punëve në mirëmbajtje të infrastrukturës; dhe
- kur INFRAKOS-i me arsye dyshon që ndërmarrja hekurudhore nuk do ta shfrytëzon trasenë e kërkuar.

Nëse numri i kërkesave për alokim të të njëjtit kapacitet të infrastrukturës tejkalon kapacitetin e lejuar të asaj traseje, INFRAKOS-i do t'i përdor rregullat e prioritetit sipas kësaj renditje:

1. shërbimet publike të transportit të udhëtarëve;
2. shërbimet e transportit të kombinuar;
3. shërbimet e transportit të mallrave nga komunikacioni ndërkombëtar; dhe
4. shërbimet tjera të transportit të mallrave.

Duke i marr parasysh prioritetet e cekura më lartë, alokimi i traseve do të bëhet sipas këtyre rregullave:

- kërkesat për trena të rregullt kanë përparësi para trenave të jashtëzakonshëm dhe të posaçëm;
- kërkesat për trase të trenave sipas kornizës së marrëveshjeve kanë përparësi nga kërkesat e reja;
- kërkesat për trase të trenave të cilët përfshihen për një periudhë të gjatë kohore, kanë përparësi nga kërkesat për periudha kohore të shkurta;
- kërkesat për trase të trenave në relacione të gjata, kanë përparësi nga trasetë e trenave në relacione të shkurta në të njëjtën rrugë udhëtim; dhe
- në rastet kur të gjitha kushtet e lartcekura janë të njëjta, do të shërbehet ai i cili i pari ka bërë kërkesën.

Nëse operatori hekurudhor mendon që i është bërë e padrejtë, ai mund ta parashtoj ankesën pranë Autoritetit Rregullativ Hekurudhor.

#### 4.4.4 Ndikimi i marrëveshjes kornizë

Marrëveshjet kornizë rregullojnë të drejtat e operatorit hekurudhor në përdorim të kapaciteteve të Infrastrukturës për periudhë kohore më të gjatë se orari i trenave njëvjeçar e cila nuk do të jetë e definuar në detaje por i mundëson operatorit hekurudhor shfrytëzimin e kapaciteteve të caktuara të infrastrukturës.

Marrëveshjet kornizë janë çështje e harmonizimit direkt në mes të Menaxherit të Infrastrukturës dhe operatorit hekurudhor, por nuk mund të nënshkruhen pa pëlqimin paraprak të Organit Rregullativ të Tregut.

#### 4.5 Alokimi i kapaciteteve për mirëmbajtje, përtëritja dhe përmirësimet

Alokimi i kapaciteteve të infrastrukturës për nevoja të punimeve në mirëmbajtje, përtëritje dhe përmirësimet e kapaciteteve hekurudhore janë pjesë përbërëse e procedurës së alokimit të kapaciteteve.

Me qëllim të mirëmbajtjes së kualitetit të caktuar, sigurisë dhe cilësisë në Infrastrukturën hekurudhore, INFRAKOS-i - Shërbimi për qasje në infrastrukturë, gjatë procedurës të hartimit të OLT-së do të rezervojnë një pjesë të kapaciteteve të hekurudhës për mirëmbajtje të rregullt për periudha kohore të caktuara dhe segmente të caktuara.

Periudhat e caktuara për mirëmbajtje të rregullt të infrastrukturës hekurudhore do të publikohet në Librezën e OLT-së.

INFRAKOS-i, një muaj më herët do t'i njofton të gjithë operatorët hekurudhor për të gjitha planifikimet e punimeve më të gjata në Infrastrukturën hekurudhore të cilat mund të kanë ndikim në realizimin e transportit.

##### 4.5.1 Procedura

Alokimi i kapaciteteve për mirëmbajtje, renovime dhe përmirësime të infrastrukturës hekurudhore e kryen shërbimi i komunikacionit, sipas procedurës për alokim ad hoc të kapaciteteve e përshkruar në pikën 4.3.2. Kërkesat dërgohen me shkrim në adresë:

Departamenti i Komunikacionit të INFRAKOS-it  
Sheshi i Lirisë pn.  
12000 Fushë Kosovë  
Republika e Kosovës  
Personi kontaktues:  
Z. Ukë Shala  
Fushë Kosovë  
Tel. +381 38 550 550 180;  
Mob. +386 49 379 008  
e-mail: [uke.shala@kosovorailway.com](mailto:uke.shala@kosovorailway.com)

Shkresat e shkruara duhet të dërgohet në afatin brenda 3 ditëve.

#### 4.6 Mosshfrytëzimi i traseve të alokuara - rregullat e anulimit

MI e posedon të drejtën e anulimit të kapaciteteve të alokuara nëse operatori hekurudhor:

- trasenë e alokuar e shfrytëzon më pak se 80% brenda 8 javësh për transportin e udhëtarëve; dhe
- më pak se 50% për transportet tjera.

MI nuk ka nevojë për informim paraprak lidhur me anulimet për rastet e përmendura.

Operatori hekurudhor mund t'i anulon kapacitetet e alokuara:

- tre muaj para realizimit të shërbimit pa kompensim;
- prej 3 muajve deri në një javë para realizimit të shërbimit duke paguar kompensimin prej 10% për trasenë e plotë të trenit;
- Prej një jave deri në 6 orë para realizimit duke paguar kompensimin prej 20% për trasenë e trenit të plotë; dhe
- më pak se 6 orë para realizimit të shërbimit duke paguar kompensimin e plotë 100% të trasesë së trenit.

Operatori hekurudhor është i obliguar që anulimin e kapaciteteve të alokuara ta paraqes me shkrim në këtë adresë:

INFRAKOS  
Z. Ukë Shala  
Sektori i komunikacionit  
Fushë Kosovë  
Tel. +381 38 550 550 180;  
Mob. +386 49 379 008  
e-mail: [uke.shala@kosovorailway.com](mailto:uke.shala@kosovorailway.com)

Në rast të dërgimit të shkresës me fax ose postë elektronike, atëherë origjinali duhet të dërgohet brenda tre ditësh. Kapacitetet e anuluar mund t'i alokohen ndonjë operatori tjetër.

## 4.7 Dërgesat e veçanta dhe mallrat e rrezikshme

### 4.7.1 Transporti i dërgesave të veçanta

Transporti i dërgesave të veçanta është transport për të cilin bëhen shmangie për më së paku për një standard teknik i cili zbatohet në infrastrukturën përkatëse, si psh shtypja e masës për bosht për metër gjatësi, profili i mjetit hekurudhor e të ngjashme.

Duke marr parasysh të gjitha elementet e nevojshme për realizimin e transportit, të dërgesave të veçanta MI vendos se a do të ndaj ose jo kapacitetet e infrastrukturës së kërkuar dhe në të cilat kushte.

Ndarja e kapaciteteve për transportin e dërgesave të veçanta kryhet në bazë të procedurës së theksuar në pikën 4.3.2.

Ndërmarrjet hekurudhore janë të obliguara që në kërkesën e vet për ndarjen e kapaciteteve, pa marrë parasysh se a bëhet fjalë për procedurën për ndarjen e kapaciteteve për OLT-në vjetore ose ndarjen ad hok të kapaciteteve, duhet të theksojnë të gjitha të dhënat për dërgesën e veçantë e cila transportohet.

Për informim detaj lajmërohuni në adresën:

INFRAKOS  
Z. Ukë Shala  
Sektori i komunikacionit  
Fushë Kosovë  
Tel. +381 38 550 550 180;  
Mob. +386 49 379 008  
e-mail: [uke.shala@kosovorailway.com](mailto:uke.shala@kosovorailway.com)

#### 4.7.2 Mallrat e rrezikshme

Transporti i mallrave të rrezikshme në infrastrukturën hekurudhore me të cilën administron MI është rregulluar me Ligjin për transportin e mallrave të rrezikshme dhe me RID.

Operatorët hekurudhor janë të obliguar të lajmërojnë çdo dërgesë të mallrave të rrezikshme e cila transportohet me trena të rregullt, klasën e RID-it dhe vendin e radhitjes në tren.

Operatorët hekurudhor janë të obliguar t'i zbatojnë marrëveshjet adekuate të cilat kanë të bëjnë me sigurinë gjatë transportit të mallrave të rrezikshme.

Ndarja e kapaciteteve për transportin e materieve të rrezikshme kryhet në bazë të procedurës dhe rregullave të përkrahura në pikën 4.3.2.

Për informim detaj lajmërohuni në adresën:

INFRAKOS  
Z. Ukë Shala  
Sektori i komunikacionit  
Fushë Kosovë  
Tel. +381 38 550 550 180;  
Mob. +386 49 379 008  
e-mail: [uke.shala@kosovorailway.com](mailto:uke.shala@kosovorailway.com)

#### 4.8 Masat e veçanta të cilat duhet ndërmarr në rast të çrregullimit të komunikacionit

Në raste të çrregullimit të komunikacionit, MI s'bashku me operatorët hekurudhor duhet të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për normalizimin e kushteve për lëvizjen e trenave në afat sa më të shkurtër.



#### 4.8.1 Parimet

Me qëllim të eliminimit të çrregullimeve në transport, Menaxheri Infrastrukturës do të ndërmerr masat e duhura për vendosje të serishme të orarit të rregullt të lëvizjes së trenave duke i marrë parasysh nevojat e udhëtarëve dhe shfrytëzuesit e transportit të mallrave dhe sigurinë e lëvizjes.

Me qëllim të eliminimit të çrregullimeve në transport, Menaxheri i Infrastrukturës mund të përdor rregullat e prioritetit, të revokoj disa trena ose t'i ndërroj trasetë e trenave në marrëveshje me operatorin hekurudhor.

Në rastet kur pritet një kohë e gjatë e ndërprerjes së transportit, Menaxheri i Infrastrukturës me pëlqim të Operatorit hekurudhor do ta harton një OLT plotësues për periudhën kohore deri sa të aftësohet linja hekurudhore.

Menaxheri i Infrastrukturës mund të kërkon ndihmë nga operatori hekurudhor me qëllim të normalizimit të kushteve të transportit, nëse ka nevojë që të kyçen edhe mjetet lëvizëse ose edhe personeli.

#### 4.8.2 Rregullat e operimit (lëvizjes së trenave)

Me qëllim të normalizimit të transportit vlejné rregullat e lëvizjes së trenave për rregullimin e transportit, të parapara me Ligjin mbi sigurinë në komunikacion hekurudhor, Rregulloren 2 dhe aktet tjera nënligjore dhe Udhëzimet e aplikueshme.

Në rastet e vonesave dhe lëvizjes së parakohshme të trenave, vlen rregulli që trenat me rang më të ulët nuk guxojnë t'i pengojnë trenat me rang më të lartë.

#### 4.8.3 Problemet e parashikuara

Për problemet e parashikueshme ndërmerren masat e nevojshme siç janë: pengesat teknike të pajisjeve SS dhe TK, CTC, fatkeqësitë elementare, bora dhe të ngjashme të parapara me Rregulloren nr. 2 dhe me rregulla tjera të aplikueshme në Infrastrukturën e Hekurudhave të Kosovës.

#### 4.8.4 Problemet e pa parashikuara

Në rastet urgjente kur Infrastruktura hekurudhore përkohësisht nuk mund të përdoret, Menaxheri i Infrastrukturës pa paralajmërim mund t'i anulon trasetë e trenave për atë periudhë kohore të nevojshme për aftësimin e infrastrukturës.

INFRAKOS-i do të tentoj t'i lajmëron të gjithë të interesuarit për situatën e ndodhur.



## 5. Shërbimet ↑

### 5.1 Hyrje

Me qëllim të realizimit të transportit në kapacitetet e alokuara të Infrastrukturës, ligjdhënësit Evropian i kanë definuar katër lloje të shërbimeve të cilat operatorët hekurudhor mund t'i shfrytëzojnë.

Shërbimet e ofruara nga INFRAKOS-i janë në harmoni me dispozitat e nenit 52 të Ligjit mbi Hekurudhat Nr. 04/L-063:

- qasje minimale të shërbimeve në pako;
- qasje në linjë deri te pajisjet shërbyese dhe shfrytëzimi i tyre;
- shërbimet shtesë; dhe
- shërbimet përcjellëse.

Ligjit mbi Hekurudhat e definojnë se të gjitha ndërmarrjet hekurudhore kanë të drejtë në bazë jo diskriminuese në qasje minimale të shërbimeve në pako dhe qasje në linjë hekurudhore deri te pajisjet shërbyese dhe shfrytëzimin e tyre. Për këtë, kërkesat e ndërmarrjeve hekurudhore mund të refuzohen vetëm atëherë nëse ekzistojnë alternativa të mundshme sipas kushteve të tregut.

INFRAKOS-i iu ofron të gjitha ndërmarrjeve hekurudhore shfrytëzimin e pakos minimale të qasjes dhe qasjen në linjë deri te pajisjet shërbyese në mënyrë jo diskriminuese duke nënshkruar marrëveshjen për qasje.

Shfrytëzimi i të gjitha pajisjeve shërbyese, objekteve shtesë dhe përcjellëse, të cilat i ofron INFRAKOS-i, do t'u mundësohen të gjitha ndërmarrjeve hekurudhore në mënyrë jo diskriminuese dhe me kërkesë të tyre dhe do të kontraktohen si të veçanta.

## 5.2 Qasja minimale e shërbimeve në pako

Pakoja minimale e shërbimeve për qasje përmban të gjitha elementet e pakos minimale të shërbimeve për qasje të definuara në nenin 52 të Ligjit mbi Hekurudhat Nr. 04/L-063 dhe përfshinë:

- trajtimin e kërkesave për kapacitetin e infrastrukturës;
- të drejtën e shfrytëzimit të kapacitetit që është dhënë;
- shfrytëzimin e ndërrueseve të binarëve dhe nyejve hekurudhore;
- kontrollin e trenit duke përfshirë sinjalizimin, rregullimin, nisjen, komunikimin dhe ofrimin e informacionit mbi lëvizjen e trenit;
- të gjithë informacionin tjetër i cili kërkohet për zbatimin apo operimin e shërbimeve për të cilat është dhënë kapaciteti.

## 5.3 Qasja në linjë deri te pajisjet shërbyese dhe shfrytëzimi i tyre

### 5.3.1 Qasja në linjë deri te pajisjet shërbyese

Qasja në linjë deri te pajisjet shërbyese dhe shfrytëzimi i tyre është definuar në nenin 52 të Ligjit mbi Hekurudhat Nr. 04/L-063 dhe përfshinë:

- shfrytëzimin dhe qasjen deri te pajisjet për furnizim me derivate të naftës;
- shfrytëzimin dhe qasjen në objekte për pastrimin e trenave dhe vagonëve;
- shfrytëzimin e stacioneve, peronave, objekteve të stacioneve dhe objekteve tjera për pranimin dhe përcjelljen e udhëtarëve;
- shfrytëzimin dhe vendosjen e vagonëve në binarët e ngarkim – shkarkimit dhe shfrytëzimin e platformave të ngarkimit dhe shkarkimit të vagonëve;
- shfrytëzimin dhe qasjen, ose vendosjen në binarë industrial;
- shfrytëzimin e objekteve dhe binarëve për formimin e trenave;
- shfrytëzimin e binarëve për parkim të mjeteve lëvizëse (vagonëve, trenave); dhe
- qasja deri te objektet për mirëmbajtje dhe objektet tjera teknike.

INFRAKOS-i do të iu mundëson qasje në linjë deri te pajisjet shërbyese të cekura më lartë të gjitha ndërmarrjeve hekurudhore të cilave iu është ndarë pakoja minimale e shërbimeve të qasjes, në mënyrë jo diskriminuese me kërkesë të tyre, me kusht që ndërmarrjet hekurudhore paraprakisht të kenë nënshkruar marrëveshjen për shfrytëzimin e këtyre pajisjeve me INFRAKOS-in.

Ndërmarrjet hekurudhore, nevojën për qasje në binar deri te pajisjet shërbyese dhe shfrytëzimin e tyre duhet ta cekin në procedurën e alokimit të kapaciteteve.

### 5.3.2 Shfrytëzimi i pajisjeve për furnizim me derivate të naftës

Në rrjetin hekurudhor të Kosovës ekzistojnë pajisjet për furnizim me derivate të naftës në stacionin e Fushë Kosovës. INFRAKOS-i ofron shërbimet e manovrimit dhe vendosjes të mjeteve lëvizëse deri te objektet për furnizim dhe nëse kontraktohet do të kryej edhe furnizimin me derivate të naftës.

### 5.3.3 Shfrytëzimi dhe qasja deri te objektet për pastrimin e trenave dhe vagonëve

INFRAKOS ofron shfrytëzimin dhe qasjen deri te objektet për pastrimin – larjen e trenave (vagonëve) në stacionin e Fushë Kosovës sipas kërkesës dhe sipas çmimit të tregut në mënyrë jo diskriminuese.

### 5.3.4 Qasja dhe shfrytëzimi i stacioneve për pranim dhe përcjellje të trenave, ndërtesat e stacioneve dhe objektet tjera

INFRAKOS u ofron ndërmarrjeve hekurudhore shfrytëzimin e të gjitha stacioneve (vendeve zyrtare) për pranim dhe përcjellje të udhëtarëve, objekteve të stacioneve dhe objekteve tjera me kërkesë të tyre në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese.

### 5.3.5 Qasja dhe vendosja e vagonëve në binarët e ngarkim - shkarkimit dhe shfrytëzimi i platformave të ngarkim – shkarkimit të vagonëve.

Me termin Terminalet e mallrave në rrjetin hekurudhor, nënkuptohen të gjitha vendet zyrtare (stacionet) e hapura për transport të mallrave në të cilat kryhet ngarkim - shkarkimi i mallrave.

INFRAKOS iu ofron të gjitha ndërmarrjeve hekurudhore shfrytëzimin e të gjitha terminaleve për transport të mallrave në mënyrë jo diskriminuese sipas kërkesës së tyre.

Në stacionin e Miradisë është i ndërtuar terminal i posaçëm që mundë t'i pranoi të gjitha llojet e dërgesave të mallrave konvencionale dhe atyre të kontejnerëve si dhe përgatitjen e tyre për dërgim deri në depon e pranuesit të mallit. Terminali disponon me kran për manipulim me kontejnerë me peshë ngritëse prej 40 tonë. Lartësia e ngritjes është 9 m, përkatësisht në pesë nivele. Hapësira e terminalit është 8000 m<sup>2</sup> e asfaltuar. Gjatësia e fushës operative është 400 metra. Terminali ka binarin për vendosjen e vagonëve në ngarkim dhe shkarkim. Në platonë e terminalit e cila është e asfaltuar mundë të vendosën 13 vagonë me kontejnerë. Pjesa tjetër është e asfaltuar dhe shërben për shkarkimin e mallrave tjerë. Terminali ka edhe rampën anësore për ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave me gjatësi prej 120 metrave.

INFRAKOS-i u ofron të gjitha ndërmarrjeve hekurudhore dhe klientëve tjerë shfrytëzimin e terminalit sipas kërkesave në mënyrë jo diskriminuese dhe sipas rregullores mbi Terminalin. Për informata shtesë kontaktoni:

Departamenti i Komunikacionit të INFRAKOS-it  
Sheshi i Lirisë pn.  
12000 Fushë Kosovë  
Republika e Kosovës  
Personi kontaktues:  
Sabit Thaqi

Tel. +381 38 550 550 132  
Mob. +386 49 222 137  
Email: [sabit.thaqi@kosovorailway.com](mailto:sabit.thaqi@kosovorailway.com)

### 5.3.6 Qasja dhe vendosja në binar industrial.

INFRAKOS-i iu ofron qasjen dhe vendosjen e vagonëve në binar industrial të gjitha ndërmarrjeve hekurudhore dhe klientëve tjerë në mënyrë jo diskriminuese sipas kërkesës së tyre.

### 5.3.7 Qasja dhe shfrytëzimi i objekteve dhe binarëve për formim të trenave

INFRAKOS-i iu ofron shfrytëzimin e objekteve dhe binarëve për formimin e trenave të gjitha ndërmarrjeve hekurudhore në mënyrë jo diskriminuese sipas kërkesës së tyre.

### 5.3.8 Qasja dhe shfrytëzimi i binarëve për deponim (parkim) të vagonëve

INFRAKOS-i iu ofron shfrytëzimin e binarëve për deponim (parkim) të gjitha ndërmarrjeve hekurudhore të cilat kanë nevojë për deponim (parkim) të parkut lëvizës në mënyrë jo diskriminuese sipas kërkesës së tyre.

Nevojat për deponim (garazhim) të parkut lëvizës i cili shfrytëzohet për çdo ditë, ndërmarrjet hekurudhore duhet t'i paraqesin në procedurë të alokimit të kapaciteteve.

Aplikimi - kërkesa për shfrytëzim të binarëve për parkim duhet të përmban:

- gjatësinë e nevojshme në metra;
- lokacionin; dhe
- mundësisht shërbimet shtesë.

### 5.3.9 Objektet për mirëmbajtje, punë, pushim dhe objektet tjera teknike

INFRAKOS-i ofron shfrytëzimin e objekteve për mirëmbajtje, punë dhe pushim për të gjitha ndërmarrjeve hekurudhore në mënyrë jo diskriminuese.

## 5.4 Shërbimet shtesë

INFRAKOS nuk është i obliguar që të ofroj shërbime shtesë por mban të drejtën të vendos se cilat shërbime shtesë do t'i ofron dhe me çfarë kushte në mënyrë jo diskriminuese dhe sipas kontratës.

Shërbimet shtesë të cilat ofrohen sipas kontratës mund të jenë:

- para ngrohja e trenave për transport të udhëtarëve;
- furnizimi me rrymë për mbushje të baterive ose ngrohje të trenit;

- furnizimi me karburante, manovrimi, dhe të gjitha shërbimet tjera të ofruara në pajisjet shërbyese të qasjes
- kontratat be posaçme për:
  - kontrollimin e transportit të mallrave të rrezikshme,
  - asistimi në lëvizjen e trenave jashtë normales
- peshimi i vagonëve në peshore të Infrastrukturës;
- manovrimi dhe bashkëveprimet në formimin e trenave të mallrave;
- dhënia e biletave, ruajtja, evidencat dhe raportimet për biletat e shitura;
- udhëheqja e evidencave doganore, lajmërimi dhe zhdoganimi i mallrave;
- evidentimi dhe udhëheqja e evidencave vagonore;
- mbikëqyrja gjatë transportit të materieve të rrezikshme; dhe
- mbikëqyrja gjatë lëvizjes së dërgesave të posaçme.

Kërkesa për shfrytëzimin e shërbimeve shtesë duhet të përmendet në procedurën e alokimit të kapaciteteve, shih Kapitullin 4.

Për informata shtesë kontaktoni:

Departamenti i Komunikacionit të INFRAKOS-it  
Sheshi i Lirisë pn.  
12000 Fushë Kosovë  
Republika e Kosovës  
Personi kontaktues:  
Z. Ukë Shala  
Fushë Kosovë  
Tel. +381 38 550 550 180;  
Mob. +386 49 379 008  
e-mail: [uke.shala@kosovorailway.com](mailto:uke.shala@kosovorailway.com)

#### 5.4.1 Shërbimet për trena (para ngrohja, furnizimi me ujë, pastrimi)

Nëse kërkohet, INFRAKOS jep shërbime për para ngrohje, për furnizimi me ujë, dhe pastrimet e tjera. Këto shërbime mund të përcaktohen me kontratë.

#### 5.4.2 Furnizimi me rrymë

INFRAKOS-i ofron shërbime të furnizimit me rrymë për ngrohje ose mbushje të akumulatorëve.

#### 5.4.3 Përgatitja e trenave për lëvizje

INFRAKOS ofron shërbime për përgatitje të trenave për nisje (formimi i trenave dhe përgatitja e dokumentacionit të trenit).

Informatat se në cilat stacione jepen shërbime për përgatitje për nisje të trenave mund të merren në këtë adresë:

MI - INFRAKOS

Z. Ukë Shala  
Fushë Kosovë  
Tel. +381 38 550 550 180;  
Mob. +386 49 379 008  
e-mail: [uke.shala@kosovorailway.com](mailto:uke.shala@kosovorailway.com)

INFRAKOS ofron shërbimin e peshimit të vagonëve në peshoren digjitale në stacionin kufitar Hani i Elezit.

#### 5.4.4 Manovrimi dhe bashkëveprimet për formimin e trenave

INFRAKOS ofron shërbimet për formimin dhe shformimin e trenave sipas kërkesave duke përfshirë orarin e manovrimit në stacionet e formimit të trenave dhe në stacionet e përcjelljes .

#### 5.4.5 Dhënia e biletave

INFRAKOS jep shërbime nëpër stacione për dhënien e biletave, ruajtjen e biletave, udhëheqjen e evidencave dhe raportimet për shitjen e biletave.

#### 5.4.6 Udhëheqja e evidencave doganore, kontrollimi dhe zhdoganimi i mallrave

INFRAKOS ofron shërbime në udhëheqjen e evidencave doganore, kontrollimin dhe zhdoganimin e mallrave.

#### 5.4.7 Evidentimi dhe udhëheqja e evidencave vagonore

INFRAKOS jep shërbime nëpër stacione në evidentimin dhe udhëheqjen e evidencave vagonore sipas kërkesave.

#### 5.4.8 Mbikëqyrja dhe shërbimet për transport të dërgesave të veçanta

INFRAKOS ofron shërbime për transport të dërgesave të veçanta sipas dispozitave për transportin e dërgesave të veçanta të parapara në Rregulloren për transport të dërgesave të veçanta.

Shërbimi përfshinë përpunimin e kërkesës nga operatori hekurudhor me qëllim të verifikimit të kushteve të transportit siç janë: profili i lirë, ngarkesa boshtore, e tjera. Shërbimi po ashtu përfshinë angazhimin shtesë të personelit të INFRAKOS-it për përgatitje dhe realizimin e transportit të dërgesës së posaçme siç janë: përcaktimi i kushteve për transport, alokimi i trasesë së trenit, angazhimi eventual i personelit për përcjellje dhe kontrollim të linjës hekurudhore gjatë kalimit të dërgesës së posaçme, eventualisht lëvizja e përkohshme e objekteve; e të tjera. INFRAKOS-i vendos se a mund të pranohet një dërgesë e posaçme për transport dhe me cilat kushte.

Për informata shtesë kontaktoni:



INFRAKOS  
Nexhmi Rama  
12000 Fushë Kosovë  
Departamenti për MLH  
Tel. + 381 38 550 550 212  
E-mal: [nexhmi.rama@kosovorailway.com](mailto:nexhmi.rama@kosovorailway.com)

#### 5.4.9 Shërbimet për transport të dërgesave me materie të rrezikshme

Informacionet për shërbime tjera të cilat i ofron INFRAKOS për transport për dërgesa me materie të rrezikshme mund të merren në adresë:

INFRAKOS  
Departamenti për MLH  
Fushë Kosovë  
Nr i tel & fak 038 550 550 222  
E-mal: [nexhmi.rama@kosovorailway.com](mailto:nexhmi.rama@kosovorailway.com)

#### 5.4.10 Shërbimet tjera shtesë

Informacionet për shërbime tjera shtesë të cilat i ofron INFRAKOS mund të merren në këtë adresë:

Departamenti i Komunikacionit të INFRAKOS-it  
Sheshi i Lirisë pn.  
12000 Fushë Kosovë  
Republika e Kosovës  
Personi kontaktues:  
Sabit Thaqi  
Tel. +381 38 550 550 132  
Mob. +386 49 222 137  
Email: [sabit.thaqi@kosovorailway.com](mailto:sabit.thaqi@kosovorailway.com)

### 5.5 Shërbimet përcjellëse

Sipas kërkesës, INFRAKOS mund të vendosë se cilat shërbime shtesë mund t'i ofrojë sipas cilave kushteve të kontratës.

Shërbimet shtesë duhet të ofrohen në mënyrë jodiskriminuese. Shërbimet shtesë mund të jenë:

- qasja në rrjetin e telekomunikimit – radio lidhjeve;
- qasja në rrjetin LAN – internet; dhe
- ofrimi i informacioneve shtesë.

Informacione detaje mund të merren në adresë:

MI - INFRAKOS  
Sektor i SS. TK dhe EN

Fushë Kosovë  
Z. Vehbi Maloku  
Nr i tel. 038 550 550 220  
Email: [vehbi.maloku@kosovorailway.com](mailto:vehbi.maloku@kosovorailway.com)

### 5.5.1 Qasja në rrjetin e telekomunikimit – radio lidhjeve

INFRAKOS ofron qasje në rrjetin e telekomunikimit dhe radio lidhjeve.

Për informata shtesë kontaktoni:

INFRAKOS  
Vehbi Maloku  
Sektori i Sinjalizimit, Telekomunikimit dhe Energjetikës  
12000, Fushë Kosovë  
Nr i tel 038 550 550 220  
E-mal. [vehbi.maloku@kosovorailway.com](mailto:vehbi.maloku@kosovorailway.com)

### 5.5.2 Qasja në rrjetin LAN - internet

INFRAKOS ofron qasje në rrjetin LAN - internet

Informacione detaje mund të merren në adresë:

MI – INFRAKOS  
Vehbi Maloku  
Sektori i Sinjalizimit, Telekomunikimit dhe Energjetikës  
12000, Fushë Kosovë  
Nr i tel. 038 550 550 220  
E-mal. [vehbi.maloku@kosovorailway.com](mailto:vehbi.maloku@kosovorailway.com)

### 5.5.3 Ofrimi i informacioneve shtesë

INFRAKOS ofron informacione shtesë edhe për shfrytëzimin e Infrastrukturës me të cilën menaxhon e e cila nuk është përfshirë në këtë Ekspoze të Rrjetit.

Informacione detaje mund të merren në adresë:

Departamenti i Komunikacionit të INFRAKOS-it  
Sheshi i Lirisë pn.  
12000 Fushë Kosovë  
Republika e Kosovës  
Personi kontaktues:  
Sabit Thaqi  
Tel. +381 38 550 550 132  
Mob. +386 49 222 137  
Email: [sabit.thaqi@kosovorailway.com](mailto:sabit.thaqi@kosovorailway.com)



## 6. Pagesat e qasjes në rrjet ↑

### 6.1 Korniza ligjore

Sipas Ligjit mbi Hekurudhat, (neni 61) Menaxheri i Infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët – INFRAKOS, e përcakton lartësinë e pagesave për shfrytëzim të infrastrukturës sipas situatës së tregut duke u bazuar në parimet e jodiskriminimit.

Pagesat e shfrytëzimit të infrastrukturës hekurudhore duhet të paguhen nga ndërmarrjet hekurudhore për:

- pakon minimale për qasje;
- qasjen në linjë hekurudhore deri te vendet zyrtare dhe shfrytëzimi i tyre;
- shërbimet shtesë; dhe
- shërbimet përcjellëse.

### 6.2 Parimet e përcaktimit të detyrimeve

Parimisht, lartësia e vlerës së detyrimeve për shfrytëzim të Infrastrukturës përcaktohet në bazë të shpenzimeve reale dhe ofrimit të shërbimeve të cilat janë të definuara në pikën 5.2 të këtij dokumenti.

Autoriteti i pagesave duhet të përcaktoj politikat e pagesave bazuar në drejtësi dhe jo diskriminim siç është cekur në Nenin 61 të Ligjit mbi Hekurudhat.

Lartësia e pagesave për shfrytëzim të Infrastrukturës definohet në varshmëri me kilometrat e realizuar të trenit, përbërjes së trenit, masës dhe shpejtësisë së trenit, shtypjes boshtore, kohëzgjatjes së shfrytëzimit të Infrastrukturës dhe sipas kërkesave të posaçme.

Lartësia e pagesave për shfrytëzim të objekteve shërbyese, caktohet në bazë të shpenzimeve të ndodhura gjatë shfrytëzimit të këtyre objekteve.

Lartësia e pagesave të shërbimeve shtesë të cilat i ofron INFRAKOS, caktohet në bazë të shpenzimeve të ndodhura gjatë ofrimit të këtyre shërbimeve.

Lartësia e pagesave për shërbime përcjellëse caktohet në bazë të kushteve të tregut.

INFRAKOS nuk kërkon pagesa shtesa të posaçme për shërbime, siç janë shtesat për mungesë ose kufizim të kapaciteteve në segmentin e linjave hekurudhore, shtesa për mbrojtje të mjedisit, shtesa për rezervim të kapaciteteve dhe as që lejon kurrfarë beneficimesh.

### 6.2.1 Pakoja minimale e shërbimeve për qasje

Lartësia e pagesave për pakon minimale të shërbimeve për qasje, përcaktohet duke u mbështetur në çmimin njësi të shfrytëzimit të Infrastrukturës sipas tren kilometrit (trenkm), përbërjes së trenit dhe gjatësisë, trasesë së trenit, parametrave të linjës, masës dhe shpejtësisë së trenit, shtypjes boshtore, si dhe kohëzgjatjes së shfrytëzimit të infrastrukturës.

Lartësia e pagesave për trase të trenit të jashtëzakonshëm – ad hock, llogaritet duke shumëzuar mesataren e orëve të punës për alokimin e traseve me mesataren e pagës së specialistit për përpilimin e orarit të trenave.

Në mënyrë të ngjashme llogaritet lartësia e pagesave për trase të trenit për të cilin hartohet orar i posaçëm, por këtu ndryshon mesatarja e orëve të punës.

### 6.2.2 Qasja në linjë deri te pajisjet shërbyese të cekura në kapitullin 5.3

Lartësia e pagesave për qasje në linjë (binarë) deri te pajisjet shërbyese nga kapitulli 5.3, përcaktohet në bazë të shpenzimeve reale për mirëmbajtje dhe menaxhim të Infrastrukturës hekurudhore.

### 6.2.3 Shfrytëzimi i pajisjeve shërbyese të cekura në kapitullin 5.3

Pagesat për shfrytëzim të pajisjeve shërbyese të cekura në kapitullin 5.3, përcaktohet në bazë të kostove të ndodhura gjatë shfrytëzimit të pajisjeve

shërbyese duke e marrë parasysh çmimin e tregut për shërbimet e ofruara dhe në bazë të konkurrencës.

#### 6.2.4 Shërbimet shtesë

Pagesat për shërbime shtesë të cekura në kapitullin 5.4 përcaktohen në bazë të shpenzimeve të ndodhura gjatë ofrimit të këtyre shërbimeve.

Pagesat për shfrytëzimin e shërbimeve shtesë aplikohen në mënyrë jo diskriminuese për të gjitha ndërmarrjet hekurudhore.

#### 6.2.5 Shërbimet përcjellëse

Pagesat për shërbime përcjellëse përcaktohen në bazë të kushteve të tregut.

### 6.3 Mënyra e llogaritjes të pagesave

#### 6.3.1 Shërbimet e përfshira në pagesa

Në pakon minimale për qasje për shfrytëzim të traseve janë të mbuluara shpenzimet për ofrim të shërbimeve të definuara në kapitullin 5.2.

Lartësia e pagesave për shfrytëzim të Infrastrukturës përcaktohet në bazë të kilometrave të trenit të realizuar në transportin e udhëtarëve dhe të mallrave.

Pakoja minimale e shërbimeve të ofruara përfshinë të gjitha elementet e pakos minimale konform nenit 52 të Ligjit mbi Hekurudhat dhe këto janë:

- përpunimi i kërkesës për kapacitete;
- e drejta për shfrytëzimin e kapaciteteve të alokuara;
- shfrytëzimi i infrastrukturës në binarët e pranimi - përcjelljes;
- menaxhimi, rregullimi dhe kontrollimi i lëvizjes së trenave duke e përfshirë sinjalizimin, rregullativën, sistemin e përcjelljes operative, komunikimin dhe ofrimin e informatave për lëvizjen e trenave;
- mirëmbajtja e rregullt e infrastrukturës; dhe
- sigurimi i të gjitha informatave tjera të domosdoshme që përdoren ose me të cilat menaxhohet komunikacioni për kapacitetet e alokuara.

#### 6.3.2 Mënyra e llogaritjes së pagesave

Mënyra e llogaritjes së pagesave është përcaktuar nga këto principe:

- kalkulimi i thjeshtë;
- saktësia;
- rregullshmëria; dhe
- varshmëria nga çmimi.

Fatura do të përfshinë pagesat për këto shërbime:

- shërbimet për pakon minimale për qasje;
- shërbimet e ofruara për qasje dhe për shfrytëzim të binarëve deri te pajisjet shërbyese;
- shërbimet shtesë;
- shërbime plotësuese;
- pagesa (lëshimi i faturimit); dhe
- reklamimet.

### 6.3.3 Formula për kalkulim (llogaritje) të pagesave të shfrytëzimit të infrastrukturës

Formula për kalkulimin (llogaritjen) e pagesave të qasjes në rrjet, respektivisht pagesave për shfrytëzimin e infrastrukturës për trenat e udhëtarëve është:

$$IUCp = (Mkmp + Okm + QIT) * Km * Lco * Tco * QIN + Mto * Gt + ASF$$

Ndërsa formula për kalkulimin (llogaritjen) e pagesave të qasjes në rrjet, respektivisht pagesave për shfrytëzimin e infrastrukturës për trenat e mallrave është:

$$IUCf = (Mkmf + Okm + QIT) * Km * Lco * Tco * QIN + Mto * Gt + ASF$$

### 6.3.4 Përshkrimi i shkurtesave të përdorura në formulat e IUC

Në tabelën e mëposhtme është përshkruar në detaje secila variabël e përdorur në formulat e mësipërme, duke e sqaruar domethënien dhe mënyrën e llogaritjes së tyre.

| Variabla<br>(shkurtesa) | Emërtimi                           | Përshkrimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
|-------------------------|------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| $Y_1$                   | Faktori variabil i brutotonëve     | Raporti ndërmjet brutotonëve $y_1$ dhe trenkilometrave totale $y_2$ , bëhet sipas vendimit të Menaxhmentit të INFRAKOS-it. Është e ditur se bruto tonët kanë ndikim më të madh në deformime se sa numri i trenave për seksionin e njëjtë të binarëve; kjo do të thotë se disa trena të rëndë të mallrave kanë ndikim më të madh në dëmtimin e binarëve se sa numri më i madh i trenave të udhëtarëve). Nëse po: $Y_1 > Y_2$ ; nëse jo: $Y_2 > Y_1$ ; nëse konsiderohet dëmtim i njëjtë, atëherë $Y_1 = Y_2$ . |
| $Y_2$                   | Faktori variabil i trenkilometrave | Njëjtë sikurse për $Y_1$                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |

|                 |                                                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
|-----------------|---------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>X</b>        | Faktori ndihmës                                   | $X = Y_1 + Y_2$                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| <b>Mkmf (x)</b> | Mirëmbajtja (€ / km) për trenat e mallrave        | Fitohet duke pjesëtuar kostot direkte të mirëmbajtjes (linjat + pajisjet) me numrin total të tren kilometrave.                                                                                                                                                                                                                                     |
| <b>Mkmf</b>     | Çmimi (€ / km) për trenat e mallrave              | $Mkmf = [Mkmf(x) / X] * Y_2$                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| <b>Mkmp (x)</b> | Mirëmbajtja (€ / km) për trenat e udhëtarëve      | Fitohet duke pjesëtuar kostot direkte të mirëmbajtjes (stacionet e udhëtarëve) me numrin total të tren kilometrave të trenave të udhëtarëve                                                                                                                                                                                                        |
| <b>Mkmp</b>     | Çmimi (€ / km) për trenat e udhëtarëve            | $Mkmp = Mkmf + Mkmp(x)$                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| <b>Mto (x)</b>  | Mirëmbajtja (€ / t)                               | Fitohet duke pjesëtuar kostot direkte të mirëmbajtjes (linjat + pajisjet) me totalin e bruto tonëve.                                                                                                                                                                                                                                               |
| <b>Mto</b>      | Çmimi (€ / t)                                     | $Mto = [Mto(x)] / X * Y_1$                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| <b>Gt</b>       | Bruto tonët (t)                                   | Paraqesin Bruto tonët për secilin tren                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| <b>Okm</b>      | Çmimi (€ / km)                                    | Fitohet duke pjesëtuar kostot direkte të mirëmbajtjes (të operimit) me numrin total të tren kilometrave.                                                                                                                                                                                                                                           |
| <b>QIT</b>      | Stimulimi (€ / km) për kualitetin e tërheqjes     | Përcaktohet në bazë të influencës të peshës së trenave në dëmtimin e infrastrukturës së binarëve.                                                                                                                                                                                                                                                  |
| <b>Km</b>       | Trenkilometrat (km)                               | Trenkilometrat për secilin tren                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| <b>Lco</b>      | Koeficienti i llojit të linjave                   | Për linjën kryesore merret 1 (një), ndërsa për linjat rajonale:<br>$Lco = [(kostot\ direkte\ të\ mirëmbajtjes\ (linjat\ +\ pajisjet)\ të\ linjave\ tjera) * (total\ tren\ kilometrat\ e\ linjave\ tjera)] / [(kostot\ direkte\ të\ mirëmbajtjes\ (linjat\ +\ pajisjet)\ të\ linjës\ kryesore) * (total\ tren\ kilometrat\ e\ linjës\ kryesore)]$ . |
| <b>Tco</b>      | Koeficienti i llojit të trenave                   | Koeficienti i bazuar në jetëgjatësinë e linjave i cili merr parasysh analizën e kostove të kualitetit të binarëve për trenat me shpejtësi të ndryshme                                                                                                                                                                                              |
| <b>QIN</b>      | Koeficienti i stimulimit të kualitetit të zhurmës | Koeficienti i cili bazohet në ndikimin e zhurmës në ambient e cila shkaktohet nga mjetet lëvizëse (deri më tani në Evropë nuk ka hyrë në funksion) = 1                                                                                                                                                                                             |
| <b>ASF</b>      | Pagesa e shërbimeve shtesë (€)                    | Tarifa për alokimin e traseve ad hok, fitohet duke shumëzuar mesataren e orëve të punës për alokimin e traseve me mesataren e pagës së specialistit për përpilimin e orarit të trenave.                                                                                                                                                            |



### 6.3.5 Koeficientet dhe vlerat e tyre

#### 6.3.5.1 Koeficienti i linjave – Lco

Ky koeficient paraqet mbingarkimin e trafikut, rëndësinë dhe kualitetin e linjës dhe reflekton pamjaftueshmërinë e kapaciteteve

| Linja hekurudhore                     | Kategoria e linjës | Lco  |
|---------------------------------------|--------------------|------|
| Fushë Kosovë – Hani i Elezit (Kufiri) | Linja kryesore     | 1    |
| Fushë Kosovë – Leshak (kufiri)        | Linja kryesore     | 1    |
| Fushë Kosovë – Prishtinë              | Linjat tjera       | 0.56 |
| Fushë Kosovë – Pejë                   | Linjat tjera       | 0.56 |
| Klinë – Xërxe                         | Linjat tjera       | 0.56 |
| Bardh - Medvec (Ferronikel)           | Linjat tjera       | 0.56 |

#### 6.3.5.2 Koeficienti i trenave - Tco

Ky koeficient bazohet në shpejtësinë e trenave dhe paraqet faktorin kryesor i cili ndikon në rritjen e mirëmbajtjes.

| Lloji i trenit                                 | Shpejtësia | Tco |
|------------------------------------------------|------------|-----|
| Trenat e mallrave (më shumë se 1000 ton bruto) | 40-60 km/h | 1.2 |
| Trenat e mallrave (më pak se 1000 ton bruto)   | 40-60 km/h | 1   |
| Trenat e udhëtarëve me garniturë motorike      | 60-80 km/h | 0.3 |
| Trenat e udhëtarëve me garniturë klasike       | 60-80 km/h | 0.5 |
| Trenat vetëm lokomotivë                        | 60-80 km/h | 0.2 |

#### 6.3.5.3 Koeficienti i kualitetit të mjeteve tërheqëse - QIT

Kualiteti i mjeteve tërheqëse ndikon shumë në infrastrukturën hekurudhore, respektivisht në linjat hekurudhore. INFRAKOS në të ardhmen do të zbaton koeficientin e kualitetit të tërheqjes sipas tabelës vijuese:

| Lloji i mjeteve tërheqëse | QIT (€ / km) |
|---------------------------|--------------|
| Klasa A                   | - 0.1        |
| Klasa B                   | 0.0          |
| Klasa C                   | + 0.1        |

Klasa e cila do të llogaritet nga INFRAKOS është klasa B sepse operatori ekzistues nuk ka pasur mundësi financiare t'i përmirësojë mjetet tërheqëse

#### 6.3.5.4 Koeficienti i zhurmës - QIN

Në formulën për përcaktimin e pagesave të shfrytëzimit të infrastrukturës (IUC) është futur edhe koeficienti i cili bazohet në ndikimin e zhurmës në ambient e cila

shkaktohet nga mjetet lëvizëse. Deri më tani në Evropë ky koeficient nuk ka hyrë në funksion, andaj edhe ne do ta marrim vlerën e tij të barabartë me 1(një).

| Koeficienti i zhurmës | QIN |
|-----------------------|-----|
| QIN                   | 1   |

#### 6.3.5.5 Shërbimet shtesë - ASF

Varësisht nga kërkesa për shfrytëzimin e traseve ad hok, INFRAKOS-i do të përdorë tarifat vijuese:

- Tarifa për trasenë ad hok për të cilën nuk nevojitet të përpilohet orar special i trenave do të paguhet 1.10 €/km;
- Tarifa për trasenë ad hok për të cilën nevojitet të përpilohet orar special i trenave do të paguhet 1.20 €/km.

### 6.4 Tarifat

Tarifat për tren kilometër në transportin e udhëtarëve dhe mallrave për vitin 2015, si dhe tarifat për ofrimin e shërbimeve tjera janë definuar në seksionet vijuese.

#### 6.4.1 Pakoja minimale e qasjes

Në këtë moment, është propozuar që çmimet për pakon minimale të bazohen në shpenzimet reale sipas kostos direkte të cilat janë llogaritur dhe prezantuar nga ana e Menaxherit të Infrastrukturës. Në tabelën vijuese janë paraqitur çmimet (tarifat) sipas formulës për pagesat e shfrytëzimit të rrjetit (IUC).

| Nr | Llojet e çmimeve (tarifave) për IUC | Vlera |
|----|-------------------------------------|-------|
| 1  | Mkmp (€ / km)                       | 3.092 |
| 2  | Mkmf (€ / km)                       | 1.998 |
| 3  | Mto (€ / t)                         | 0.595 |
| 4  | Okm (€ / km)                        | 1.961 |

#### 6.4.2 Shërbimet për qasje në binarë sipas kapitullit 5.3

##### 6.4.2.1 Shfrytëzimi dhe qasja deri te objektet dhe pajisjet për furnizim me derivate të naftës

Për momentin INFRAKOS-i nuk e ofron këtë shërbim.

##### 6.4.2.2 Shfrytëzimi dhe qasja në objekte për pastrimin- larjen e trenave dhe vagonëve

Për vendosjen dhe tërheqjen e trenave – vagonëve në pllakën për larje, për angazhimin shtesë dhe ofrimin e shërbimeve caktohet çmimi prej 10 €.

#### 6.4.2.3 Shfrytëzimi i objekteve për pranimin dhe përcjellje të udhëtarëve (sallave të pritjes dhe objekteve tjera)

Për shfrytëzimin e objekteve përcjellëse për pranimin dhe përcjelljen e udhëtarëve caktohet çmimi mujor prej (1 € për m<sup>2</sup> për salla të pritjes dhe 1.20 € për m<sup>2</sup> për zyra në të cilat jepen biletat).

#### 6.4.2.4 Shfrytëzimi dhe vendosja e vagonëve në binarët e shkarkimit dhe shfrytëzimi i platformave ngarkuese

Për vendosjen e vagonëve në binarët e shkarkimit dhe shfrytëzimin e platformave ngarkuese, caktohet çmimi prej 5 € për vagon. Kjo vlen edhe për vendosje të vagonëve në terminalin e mallrave në Miradi. Nëse në shkarkim ose ngarkim vendoset një tren (Trenat për nevoja të KFOR-it e tjerë, atëherë çmimi për një tren do të jetë 20 €).

#### 6.4.2.5 Shfrytëzimi dhe qasja ose vendosja e vagonëve në binar Industrial.

Për vendosje të vagonëve në binar industrial çmimet janë të caktuara varësisht prej binarit industrial sipas tabelës vijuese:

| Stacioni     | Pronari i binarëve industrial                                                                                  | Çmimi për vendosje                                                                                           |
|--------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1            | 2                                                                                                              | 3                                                                                                            |
| Mitrovicë    | 1. Trepça industria kimike<br>2. Fabrika e betonit<br>3. Pajisjet procesore                                    | 5 € për vagon<br>i pa përdorshëm<br>i pa përdorshëm                                                          |
| Vushtrri     | 1. Llamkosi                                                                                                    | 5 € për vagon ose 30 €<br>për tren, varg manovrues                                                           |
| Kastriot     | 1. Binari i KEK-ut<br>2. Binari i KEK-KOSOVA „B”                                                               | 30 € për tren ose varg<br>manovrues                                                                          |
| Fushë Kosovë | 1. Fam – Gas<br>2. Silosit                                                                                     | 30 € për tren ose varg<br>manovrues<br>5 € për vagon                                                         |
| Miradi       | 1. Standard Plin<br>2. Besoil<br>3. Patroni Kompani<br>4. Petroll Kompani<br>5. Alb Petroll<br>6. Stadard Benz | 5 € për vagon<br>5 € për vagon<br>5 € për vagon<br>5 € për vagon<br>5 € për vagon<br>20 € për varg manovrues |
| Lypjan       | 1. Fabrika e letrës                                                                                            | 5 € për vagon                                                                                                |
| Bablak       | 1. HIP- Petroll                                                                                                | 3 € për vagon                                                                                                |
| Ferizaj      | 1. Fabrika e gypave<br>2. Fabrika e vajit                                                                      | 7 € për vagon<br>7 € për vagon                                                                               |

|             |                           |                         |
|-------------|---------------------------|-------------------------|
|             | 3 .Depo bujqësore         | 7 € për vagon           |
| Kaçanik     | 1. Fabrika e gëlqeres     | 7 € për vagon           |
| Hani Elezit | 1 Fabrika e cementit      | 2 € për vagon           |
| Drenas      | 1 Ferronikeli             | 10 € për varg manovrues |
| Klinë       | 1. Silosi                 | 5 € për vagon           |
| Pejë        | 1. Fabrika e birrës       | 5 € për vagon           |
|             | 2. Fabrika e sheqerit     | 5 € për vagon           |
|             | 3. Fabrika e auto pjesëve | 5 € për vagon           |
|             | 4. Kombinati i drurit     | 5 € për vagon           |
| Xërxe       | 1. Silosi                 | 20 € për tren           |

#### 6.4.2.6 Shfrytëzimi i objekteve dhe binarëve për formimin e trenave

Për shfrytëzim të kapaciteteve të binarëve në терминалет e mallrave (stacioneve) për formimin/ grupimin e vagonëve për 6 orët e para nuk do të llogaritet pagesa, por për qëndrim më të gjatë se gjashtë orë të vagonëve në binarët e formimit të trenave për çdo orë të fillimit për një vagon llogaritet çmimi prej 2.00 €.

#### 6.4.2.7 Shfrytëzimi i binarëve për parkim të vagonëve

INFRAKOS lejon shfrytëzimin e binarëve për parkimin e vagonëve ose mjeteve tjera lëvizëse.

Për shfrytëzim të kapaciteteve – binarëve në stacione për parkim të vagonëve ose mjeteve tjera lëvizëse llogaritet çmimi prej 1.00 € për një vagon për çdo 24 orë të qëndrimit dhe kjo vazhdon në mënyrë suksessive për 24 orët vijuese.

Për qëndrimin e vagonëve në binarët e ngarkimit - shkarkimit për 10 orët e para nuk paguhet, por për qëndrim më të gjatë për fillimin e çdo ore nga 2 €.

Për transporte të KFOR-it për 12 orët e para nuk llogaritet pagesa, por për qëndrim më të gjatë për çdo orë të filluar nga 1 € për vagon.

#### 6.4.2.8 Qasja deri te objektet për mirëmbajtje dhe objektet tjera teknike

INFRAKOS mundëson qasje deri te objektet për mirëmbajtje dhe objektet tjera teknike .

Për ofrimin e shërbimeve për qasje deri te objektet për mirëmbajtje dhe objekte tjera teknike llogaritet çmimi prej 5 € për vagon.

### 6.5 Ofrimi i shërbimeve sipas kapitullit 5.4

#### 6.5.1 Para ngrohja e trenave të udhëtarëve

INFRAKOS-i nuk ofron shërbime për para ngrohjen e trenave të udhëtarëve.

#### **6.5.2 Furnizimi me rrymë për mbushjen e baterive**

INFRAKOS ofron mundësin e shfrytëzimit të pajisjeve për kyçe në rrymë për mbushje të baterive të vagonëve ose garniturave motorike. Për çdo orë të shfrytëzimit të një kyçe në rrymë për mbushje të baterive llogaritet çmimi prej 5 €.

#### **6.5.3 Manovrimi, formimi i trenave të udhëtarëve dhe përgatitja e dokumentacionit për trenat e udhëtarëve në nisje**

INFRAKOS ofron shërbime në stacionet e nisjes për formimin e trenave të udhëtarëve dhe përgatitjen e dokumentacionit për nisje.

Për ofrimin e këtyre shërbimeve çmimi është 10 € për tren, ndërsa për trena të mallrave pa personel 20 €.

#### **6.5.4 Peshimi i vagonëve në peshore të Infrastrukturës**

INFRAKOS ofron shërbime për peshimin e vagonëve në peshoren digjitale në stacionin Hekurudhor Hani i Elezit.

Për peshim të çdo vagoni për shfrytëzim të peshores çmim është 5. €.

#### **6.5.5 Manovrimi dhe bashkëveprimet në formimin e trenave të mallrave**

INFRAKOS ofron shërbime për manovrim dhe bashkëvepron në formimin e trenave të mallrave në stacionin e Miradisë dhe në stacionet tjera të nisjes së trenave.

Për këto shërbime të ofruara caktohet çmimi prej 10 € për çdo tren.

#### **6.5.6 Shitja e biletave**

INFRAKOS ofron shërbimet e kërkuara për dhënie të biletave, rezervimin e tyre, evidentimet dhe raportimet për biletat e shitura.

Çmimi për të gjitha këto shërbime është 15% nga vlera e biletave të shitura.

#### **6.5.7 Udhëheqja e evidencave doganore, lajmërimi dhe zhdoganimi i mallrave.**

INFRAKOS do të kryej edhe shërbimet të cilat kanë të bëjnë me udhëheqjen e evidencave doganore, lajmërimin e doganës për arritje të vagonëve dhe kontrollimet me doganier për zhdoganimin e mallrave nëse ato kërkojnë. Çmimi për shërbime të ofruara të lart cekura është për çdo vagon të lajmëruar dhe të zhdoganuar nga 5 € (për të gjitha punët rreth zhdoganimit të vagonëve).

### 6.5.8 Evidentimi dhe udhëheqja e evidencave vagonore

INFRAKOS ofron edhe shërbime të cilat kanë të bëjnë me evidentimin dhe udhëheqjen e evidencave vagonore nëse ato kërkohen.

Çmimi për shërbimet e ofruara për evidentimin dhe udhëheqjen e evidencave vagonore është:

- Për evidentim- regjistrim të një vagoni në vag -1 nga 1 €
- Për evidentim- ç'regjistrim të një vagoni në vag -1 nga 1 €
- Për evidentim dhe dorëzim të vagonëve me vag-4 klientëve për çdo vagon nga 3 €
- Për mbikëqyrje gjatë shkarkimit dhe pranim të vagonit në kthim nga 5 € për çdo vagon.

### 6.5.9 Mbikëqyrja e transportit të materieve të rrezikshme

Nëse kërkohet INFRAKOSi do të ofron edhe shërbimin e mbikëqyrjes dhe përcjelljes së transporteve me materie të rrezikshme. Pagesa për përcjelljen e trenave të tillë do të jetë sipas marrëveshjes për llojin dhe distancën e trenave.

### 6.5.10 Mbikëqyrja gjatë lëvizjes së dërgesave të posaçme

Nëse kërkohet INFRAKOSi do të ofron edhe shërbimin e mbikëqyrjes dhe përcjelljes së transporteve me dërgesa të posaçme. Pagesa për përcjelljen e trenave të tillë do të jetë sipas marrëveshjes për llojin dhe distancën e trenave.

### 6.5.11 Shërbimet ndihmëse

#### 6.5.11.1 Rrjeti i telekomunikimit

Tarifat dhe pagesat e lidhura me shfrytëzimin e rrjetit të telekomunikimit do të definohen sipas marrëveshjes së posaçme.

#### 6.5.11.2 Ofrimi i të dhënave plotësuese për komunikacion

Për ato marrëveshje që janë bërë në lidhje me shërbimet ndihmëse për të dhëna për çështje të komunikacionit, tarifat janë bazuar në përmbajtjen e shërbimit të pakos minimale për qasje.

#### 6.5.11.3 Testimi i mjeteve lëvizëse në rrjetin hekurudhor të INFRAKOS-it

Tarifat për testimin e mjeteve lëvizëse në trase do të përcaktohen me marrëveshje të veçantë.

## 6.6 Pagesat për vonesat e trenave

Vonesat e trenave varësisht nga arsyeja ndahen në vonesa primare dhe sekondare.

INFRAKOS do të llogarit vetëm vonesat primare. Shembujt e vonesave primare për të cilat përgjigjet INFRAKOS-i janë vonesat e shkaktuara për arsye të:

- Shpejtësive të ngadalësuara;
- Mbylljes të pa planifikuar të linjës hekurudhore për arsye të punimeve në Infrastrukturë;
- Pengesave në pajisjet sinjalo – siguruese; dhe
- Rasteve të jashtëzakonshme me fajin e Infrastrukturës.

Shembujt e vonesave primare për të cilat përgjigjet ndërmarrja hekurudhore janë vonesat e shkaktuara për arsye të:

- vazhdimet të lëvizjes për arsye të tërheqjes;
- vonesave për arsye të përbërjes së trenit, garniturës ose lokomotivës;
- defektit të lokomotivës;
- defektit të vagonit; dhe
- ndodhive të jashtëzakonshme me fajin e ndërmarrjes hekurudhore.

INFRAKOS-i përcakton përgjegjësin për vonesat primare.

Rastet tjera të vonesave konsiderohen si sekondare dhe për këto nuk bëhet përllogaritje.

Nëse ndërmarrja hekurudhore nuk pajtohet me vendimin e INFRAKOS-it, e njëjta e ka të drejtën e ankesës brenda 10 ditësh pas pranimit të vendimit të INFRAKOS-it. Të gjitha ankesat duhet të shqyrtohen brenda afatit prej 30 ditësh.

Pagesat për vonesa llogariten sipas minutave të vonesës për çdo tren veçmas.

Pagesat për vonesa janë 0.1% nga traseja e plotë e trenit për një minutë të vonesës. Pagesa për vonesa të një treni nuk mund ta tejkalon 5 % të kostos të një traseje të trenit.

## 6.7 Ndryshimet e pagesave

INFRAKOS-i analizon hollësisht gjendjen e tregut në sektorin e transportit dhe sektorët tjerë ekonomik të Kosovës dhe rajonit, në mënyrë që të ofroj pagesa të orientuara drejt tregut apo pagesa të cilat e promovojnë transportin hekurudhor.

Çfarëdo propozime për ndryshime në sistemin e pagesave janë të mirëseardhura dhe do të trajtohen sipas procedurës së këshillimit që është e përfshirë në ligjin mbi hekurudhat dhe rregulloren e ARH-së 01/2013.

## 6.8 Faturimi

Të gjitha pagesat duhet të bëhen sipas faturave. Pagesat duhet të kryhen brenda 30 ditëve nga data e faturimit.



Në rast të vonesës së pagesave do të llogaritet kamata për vonesa sipas legjislacionit në fuqi të Kosovës.

Në mënyrë që të zvogëlohet rreziku i mospagesës, INFRAKOS-i ka të drejtë të kërkoj avans të pagesës, në formë të garancionit apo transferimit bankar.

INFRAKOS-i mund ta zbaton këtë klauzolë sa herë konstaton se ndërmarrja hekurudhore ka vështirësi të bëjë pagesat apo nuk i ka bërë ato në kohën e përcaktuar.

Klienti e gëzon të drejtën e kërkesës për shtyrjen e afatit të pagesës përtej 30 ditëve nga dita e faturimit. INFRAKOS-i duhet të vendosë brenda 5 ditëve, ndërsa vendimi do të jetë detyrues.

Pala përgjegjëse për pagesa është ndërmarrja hekurudhore e cila ka nënshkruar marrëveshjen për shërbimin përkatës.

#### **6.9 Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)**

Të gjitha pagesat nga kapitulli 6 (gjashtë) janë pa TVSH. Gjatë faturimit do të llogaritet edhe TVSH-ja.

## 7. *Shtojcat* ↑

- 1.1 Draft marrëveshja mbi qasjen në infrastrukturën hekurudhore
- 1.2 Distanca në mes të vendeve zyrtare
- 1.3 Gjatësia më e madhe e lejuar e trenave
- 1.4 Pjerrtësia dhe rezistenca në linja hekurudhore
- 1.5 Masa më e madhe e lejuar
- 1.6 Orari i punës në linja dhe stacione hekurudhore
- 1.7 Pasqyra e stacioneve të hapura për transport të mallrave dhe udhëtarëve
- 2.1 Formulari për porositje të trasesë së trenave
- 2.1(2) Udhëzimi për plotësimin e formularit
- 3.1 Afatet e hartimit të OLT-së
- 3.2 Afatet për hartimin e plotësimeve dhe ndryshimeve të OLT-së
- Profili ngarkues
- Profili i lirë
- Rrjeti i Hekurudhave të Kosovës (kategorizimi i linjave)
- Rrjeti i Hekurudhave të Kosovës me stacione
- Linjat e Hekurudhave të Kosovës me emërtimin e stacioneve dhe vendqëndrimeve
- Rrjeti i mënyrës së sigurimit të stacioneve
- Rrjeti i komunikimit me radio-lidhje

## Shtojca 1.1: Draft marrëveshja mbi qasjen në infrastrukturën hekurudhore



LOGO DHE EMRI I  
OPERATORIT TË  
TRANSPORTIT

**MARRËVESHJE MBI QASJEN  
NË INFRASTRUKTURËN HEKURUDHORE  
PËR VITIN 2016/2017**

**NDËRMJET**

**INFRAKOS DHE OPERATORIT TË TRANSPORTIT "Emri i operatorit të  
transportit"**

**Fushë Kosovë  
2017**

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA - INFRAKOS e ngarkuar për menaxhimin, mirëmbajtjen, ndërtimin dhe ofrimin e shërbimeve të infrastrukturës hekurudhore; me adresë në Rr. Sheshi i Lirisë, pn. në Fushë Kosovë; me numër të regjistrimit të biznesit 70325327, e përfaqësuar nga z. Agron Thaçi, Kryeshef Ekzekutiv

dhe

"Emri i operatorit të transportit" e ngarkuar me ofrimin e shërbimeve të transportit hekurudhor të udhëtarëve dhe mallrave, si dhe tërheqjen dhe mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse; me adresë në "Adresa e operatorit të transportit"; me numër të regjistrimit të biznesit 00000000, e përfaqësuar nga "Emri dhe mbiemri i drejtorit të operatorit të transportit".

lidhin

## **MARRËVESHJEN MBI QASJEN NË INFRASTRUKTURËN HEKURUDHORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2016/2017**

### **I. Dispozitat e përgjithshme**

#### **Objekti i Marrëveshjes Neni 1**

1.1 Objekti i kësaj Marrëveshjeje është që të përcaktohen kushtet administrative, teknike dhe financiare lidhur me procesin e qasjes në infrastrukturën hekurudhore ndërmjet INFRAKOS dhe "Emri i operatorit të transportit", të definuara me nenin 72 , paragrafët 4, 5 dhe 6 të Ligjit mbi Hekurudhat nr. 04/L-063 të datës 14.11.2011.

1.2 Në Shtojcën 1 të kësaj marrëveshjeje janë paraqitur të gjitha shërbimet të cilat i ofron INFRAKOS-i dhe të cilat janë objekt i kësaj marrëveshjeje.

1.3 Në Shtojcën 2 të kësaj marrëveshjeje janë paraqitur listat e traseve të kontraktuara të trenit ndërmjet INFRAKOS dhe "Emri i operatorit të transportit" për periudhën e orarit të trenave 2016/2017. Përveç traseve nga Shtojca 2, kjo marrëveshje ka të bëjë edhe me trasetë e caktuara të kërkuara ad hok nga "Emri i operatorit të transportit", si dhe ato për të cilat përpilohet orari i veçantë i lëvizjes.

1.4 Të gjitha shërbimet tjera të cilat i ofron INFRAKOS-i dhe nuk gjenden në Shtojcën 1 të kësaj marrëveshjeje, nuk janë objekt i kësaj marrëveshjeje dhe si të tilla duhet të kontraktohen me marrëveshje të veçantë.

### **Përkufizimet Neni 2**

Disa prej shprehjeve të përdorura në këtë marrëveshje e kanë këtë kuptim:

- **Qasja në infrastrukturën hekurudhore** – nënkupton të drejtën e operatorit hekurudhor që të zhvillon transportin hekurudhor në infrastrukturën hekurudhore në pajtim me këtë marrëveshje;
- **Traseja e trenit** – nënkupton kapacitetin e shfrytëzimit të pjesës së caktuar të infrastrukturës hekurudhore brenda një kohe të caktuar;
- **Trenkilometër** – nënkupton njësinë e cila paraqet lëvizjen e një treni në gjatësi prej një kilometri në trasenë e kontraktuar;
- **Trasekilometër** – nënkupton njësinë matëse për gjatësinë e trasesë të shprehur në kilometra;
- **Orari i trenave** – nënkupton udhëzimin e përpiluar nga Menaxheri i Infrastrukturës – INFRAKOS i cili përcakton kohën e nisjes dhe arritjes së trenave në stacione dhe vendndalimet tjera të planifikuara e gjithashtu edhe kohën e pritjes dhe informacionin tjetër që është i rëndësishëm për sigurinë e komunikacionit hekurudhor;
- **Ekspozeu i rrjetit** – nënkupton ekspozeun i cili paraqet në detaje rregullat e përgjithshme, afatet, procedurat dhe kriteret e skemave të pagesave dhe alokimit të kapaciteteve duke përfshirë informatën e kërkuar e cila mundëson aplikimin për kapacitetet e infrastrukturës. Kjo po ashtu nënkupton katalogun e shërbimeve të ofruara nga menaxheri i infrastrukturës dhe kushtet që duhet plotësuar për të siguruar qasjen në infrastrukturën hekurudhore;
- **Pala e tretë** – nënkupton secilin person fizik apo juridik i cili nuk është palë e kësaj marrëveshjeje.

### **Fusha e zbatimit të marrëveshjes Neni 3**

Fusha e zbatimit të kësaj marrëveshjeje është e ndërlidhur me qasjen në Infrastrukturën Hekurudhore të Republikës së Kosovës e cila menaxhohet nga INFRAKOS-i.

### **Licencat dhe certifikatat e sigurisë Neni 4**

4.1 Menaxheri i Infrastrukturës Hekurudhore në Shfrytëzim të Përbashkët – INFRAKOS e ka licencën e vlefshme nr. KS 02/ 20120001 të datës 15.11.2012

dhe autorizimin e sigurisë nr. KS 21 2013 0001 të datës 24.01.2013 të lëshuar nga Departamenti Ligjor dhe i Licencimeve i Autoritetit Rregullativ Hekurudhor i Republikës së Kosovës.

4.2 "Emri i operatorit të transportit" e ka licencën e vlefshme nr. 0000000 të datës 00.00.2000 dhe certifikatën e sigurisë nr. 0000000 të datës 00.00.2000 të lëshuar nga Departamenti Ligjor dhe i Licencimeve i Autoritetit Rregullativ Hekurudhor i Republikës së Kosovës.

### **Rregullat operative dhe teknike Neni 5**

5.1 Palët e marrëveshjes pajtohen se do të veprojnë në pajtim me rregullat të cilat zbatohen në komunikacionin hekurudhor, e në veçanti me ato të cilat janë përcaktuar me Ligjin mbi Hekurudhat nr. 04/L-063 të datës 14.11.2011 dhe rregulloret tjera në fuqi me të cilat rregullohet komunikacioni hekurudhor në Kosovë.

5.2 Lista e akteve, udhëzimeve dhe rregulloreve të cilat janë në zbatim në Infrastrukturën e Hekurudhave të Kosovës ShA është paraqitur në Shtojcën 3.

### **Mbrojtja e mjedisit Neni 6**

Palët e marrëveshjes zotohen se do të veprojnë në pajtim me rregullat me të cilat rregullohet mbrojtja e mjedisit.

## **II. Detyrimet e operatorit hekurudhor Neni 7**

7.1 "Emri i operatorit të transportit" është i obliguar që të bënë pagesën për shfrytëzimin e infrastrukturës në pajtim me kushtet e kësaj marrëveshjeje.

7.2 "Emri i operatorit të transportit" është i obliguar që t'i kryen shërbimet e transportit në pajtim me kushtet e definuara për trasenë hekurudhore e cila i është ndarë gjatë procesit të alokimit të kapaciteteve të infrastrukturës.

### **Neni 8**

8.1 Gjatë kryerjes së transportit, operatori hekurudhor do të përdorë mjetet lëvizëse në pajtim me vendimin e përshkruar në nenin 5 të kësaj marrëveshjeje.

8.2 Parku i mjeteve lëvizëse duhet t'i plotësojë kushtet për zhvillim të sigurt të komunikacionit, kushtet për zhvillim të komunikacionit sipas orarit të lëvizjes së trenave, si dhe kushtet të cilat e mundësojnë zhvillimin e komunikacionit pa dëmtim dhe konsumim të infrastrukturës hekurudhore.

**Neni 9**

"Emri i operatorit të transportit" për zhvillimin e transportit do të shfrytëzojë personelin në pajtim me vendimin e përcaktuar nga neni 5 i kësaj marrëveshjeje.

**Neni 10**

10.1 "Emri i operatorit të transportit" nuk guxon që të ia jep palëve të treta kapacitetin hekurudhor i cili i është ndarë atij.

10.2 Kur "Emri i operatorit të transportit" gjatë kryerjes së shërbimeve të transportit shfrytëzon shërbimet e operatorit tjetër hekurudhor apo personit juridik i cili kryen transport për nevojat e veta, ai guxon t'i shfrytëzojë vetëm shërbimet e atij operatori hekurudhor apo personi juridik të cilët kryejnë transportin për nevojat e veta e të cilët posedojnë leje të vlefshme për kryerjen e shërbimeve të transportit hekurudhor, respektivisht certifikatë të sigurtisë për kryerjen e transportit hekurudhor.

**III. Organizimi i transportit****Neni 11**

"Emri i operatorit të transportit" do të bënë sigurimin e personelit i cili është kompetent për zhvillimin e transportit. Personeli i cili është përgjegjës për zhvillimin e transportit hekurudhor duhet t'i plotësojë kushtet sipas rregulloreve në fuqi.

**Neni 12**

12.1 "Emri i operatorit të transportit" do të ia dorëzon INFRAKOS-it të dhënat e nevojshme mbi planin e qarkullimit të trenave në pajtim me rregulloren mbi rregullimin e komunikacionit.

12.2 "Emri i operatorit të transportit" dhe Menaxheri i Infrastrukturës - INFRAKOS bëjnë shkëmbimin e informatave të transportit në pajtim me rregulloren mbi rregullimin e komunikacionit.

**IV. Pagesat për qasje në infrastrukturë****Neni 13**

13.1 Njësia për llogaritjen e pagesave të qasjes në infrastrukturë është trenkilometri (në vijim: tkm).

13.2 Pagesa për qasjen në infrastrukturë llogaritet në bazë të trenkilometrave të kaluara për një trase të caktuar të trenit.

13.3 Modeli i llogaritjes së pagesave të qasjes në infrastrukturë me çmimin bazë të qasjes për orarin e lëvizjes së trenave për vitin 2016/2017 është paraqitur në Shtojcën 4 të kësaj marrëveshjeje.

#### Neni 14

14.1 INFRAKOS-i për çdo muaj do të bënë llogaritjen e pagesave të qasjes në rrjet për muajin paraprak dhe ta bënë faturimin në adresë të "Emri i operatorit të transportit". Llogaritja e pagesës do të bëhet për çdo trase treni që shfrytëzon "Emri i operatorit të transportit" sipas formulës së përshkruar në Shtojcën 4 të kësaj marrëveshjeje.

14.2 "Emri i operatorit të transportit" në ditën e dytë të punës të muajit vijues, duhet t'ia dorëzojë INFRAKOS-it dosjen e detajuar me lëvizjet e trenave për muajin paraprak sipas modelit për deklarimin e qarkullimit të trafikut të bashkëngjitur në Shtojcën 2 të kësaj marrëveshjeje. Në rast se deklarimi nuk arrin me kohë, INFRAKOS-i do të ketë të drejtën e faturimit të pagesës për "Emri i operatorit të transportit" në bazë të rezervimit të traseve të trenit dhe regjistrimit të tyre në sistemin e informacionit të INFRAKOS-it gjatë tërë muajit paraprak.

14.3 "Emri i operatorit të transportit" do të bënë pagesën për qasjen në infrastrukturë në xhirollogarinë bankare të INFRAKOS-it 1114103681020188 në Pro Credit Bankë, më së largu 30 ditë nga dita e pranimi të faturës. Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit të caktuar, atëherë do të bëhet llogaritja e kamatës e paraparë me aktet ligjore në fuqi sipas BQK-së

#### **Sigurimi i pagesave dhe garancioni financiar** **Neni 15**

15.1 "Emri i operatorit të transportit" gjatë nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje do të ia dorëzon INFRAKOS-it garancionit bankar me të cilin do të mbulohen pagesat e qasjes në rrjet për së paku një muaj (në vlerën prej 70,000.00 eurosh) dhe i cili mund të ekzekutohet pa problem nga INFRAKOS-i në afatin brenda 30 ditësh në rast mospagese.

15.2 Nëse "Emri i operatorit të transportit" nuk ia dorëzon INFRAKOS-it garancionin bankar ditën e nënshkrimit të marrëveshjes, kjo nënkupton se marrëveshja nuk është nënshkruar.

15.3 Nëse "Emri i operatorit të transportit" nuk e bënë kryerjen e obligimeve të veta sipas nenit 12 të kësaj marrëveshjeje, atëherë INFRAKOS-i në afatin prej 30 ditësh e ka të drejtën e ekzekutimit të garancionit bankar sipas paragrafit 1 të këtij neni.



15.4 Në rast të shfrytëzimit të garancionit bankar nga ana e INFRAKOS-it, "Emri i operatorit të transportit" është i obliguar që në afatin prej 10 (dhjetë) ditësh të ia dorëzon INFRAKOS-it garancionin e ri bankar sipas paragrafit 15.1 të këtij neni.

15.5 Nëse "Emri i operatorit të transportit" nuk e dorëzon garancionin e ri bankar brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 13.4, atëherë INFRAKOS-i e ka të drejtën e shkëputjes së marrëveshjes në afat prej 20 (njëzet) ditësh, ashtu që "Emri i operatorit të transportit" do të ketë për obligim që të ia paguaj INFRAKOS-it të gjithë dëmin i cili del si pasoj e shkëputjes së marrëveshjes.

15.6 Para se të nënshkruhet marrëveshja për vitin vijues (2016/2017), "Emri i operatorit të transportit" ka për obligim që t'i shlyej të gjitha obligimet financiare ndaj INFRAKOS-it për vitin paraprak (2015/2016).

## **V. Detyrimet e Menaxherit të Infrastrukturës**

### **Neni 16**

16.1 Menaxheri i Infrastrukturës – INFRAKOS obligohet që infrastruktura hekurudhore të cilën e shfrytëzon operatori i transportit t'i plotëson kushtet për zhvillim të sigurt të komunikacionit, kushtet për zhvillimin e komunikacionit sipas orarit të lëvizjes së trenave, si dhe kushtet të cilat mundësojnë një transport të padëmtuar dhe konsumim të panevojshëm të mjeteve lëvizëse.

16.2 Menaxheri i Infrastrukturës – INFRAKOS e lajmëron operatorin e transportit – "Emri i operatorit të transportit" për lëvizjen e trenave, anulimin e trenave, ndërprerjen e komunikacionit hekurudhor, nevojën e zëvendësimit të trenave të udhëtarëve me autobusë, ndryshimin e trasesë së transportit dhe rivendosjen e trasesë së transportit.

16.3 Dhënien e të gjitha këtyre informatave INFRAKOS-i e bënë me shpenzimet e veta, duke i lajmëruar njëkohësisht "Emri i operatorit të transportit" dhe hekurudhat fqinje.

16.4 Menaxheri i Infrastrukturës – INFRAKOS e bartë përgjegjësinë për dëmet eventuale të cilat i pëson "Emri i operatorit të transportit" në rast të moszhvillimit të transportit sipas traseve të ndara me këtë marrëveshje, për shkak të zhvillimit të punëve në infrastrukturë. Kjo nuk vlen për rastet kur kryerja e punëve bëhet sipas planifikimeve të përcaktuara në kapitullin 3; nenin 3.5 të Ekspozeut të Rrjetit.

16.5 Menaxheri i Infrastrukturës – INFRAKOS nuk bartë përgjegjësi për dëmet eventuale të cilat i pëson "Emri i operatorit të transportit" për shkak të mosrealizimit të shërbimeve të transportit për trasetë e trenave të

jashtëzakonshëm të dhëna me këtë marrëveshje, e të cilat dëme ndodhin si pasojë e punëve në infrastrukturë.

## **VI. Saktësia e trenave të udhëtarëve**

### **Neni 17**

17.1 Palët e marrëveshjes zotohen se do të bëjnë çmos që të sigurojnë lëvizjen e saktë të trenave të udhëtarëve. Në rast të devijimit nga orari i lëvizjes së trenave sipas Shtojcës 2 të kësaj marrëveshjeje, palët (varësisht nga shkaku i vonesës) marrin për obligim që të bëjnë kompensimin e vonesave të trenave të caktuar. Mënyra e përcaktimit të shkaktarit të vonesës dhe llogaritja e lartësisë së kompensimit është rregulluar sipas Shtojcës 6 të kësaj marrëveshjeje.

17.2 Menaxheri i Infrastrukturës – INFRAKOS obligohet që në baza ditore ta informojë Operatorin e Transportit – “Emri i operatorit të transportit” lidhur me vonesat e trenave të udhëtarëve për ditën paraprake, respektivisht ta informojë atë për të gjitha vonesat e trenave duke e potencuar shkakun dhe kohëzgjatjen e vonesës por pa u lëshuar në atë se kush është përgjegjës për vonesën.

## **VII. Anulimi i trenave të udhëtarëve dhe mallrave**

### **Neni 18**

18.1 Kur vonesa e trenave të udhëtarëve dhe të mallrave ndodhë për shkak të Menaxherit të Infrastrukturës – INFRAKOS ose Operatorit të Transportit – “Emri i operatorit të transportit”, atëherë vlera e llogaritur e kompensimit për shkak të vonesës së trenave bëhet sipas Shtojcës 6 të kësaj marrëveshjeje.

18.2 Menaxheri i Infrastrukturës (INFRAKOS) e posedon të drejtën e anulimit të traseve të alokuara nëse operatori hekurudhor:

- trasenë e alokuar e shfrytëzon më pak se 80% brenda 8 javësh për transportin e udhëtarëve; dhe
- më pak se 50% për transportet tjera.

Menaxheri i Infrastrukturës - INFRAKOS nuk ka nevojë për informim paraprak lidhur me anulimet për rastet e sipërpërmendura.

18.3 Operatori i Transportit – “Emri i operatorit të transportit” mund ta anulojë trasenë e ndarë të infrastrukturës:

- tre muaj para realizimit të shërbimit pa kompensim;
- prej 3 muajve deri në një javë para realizimit të shërbimit duke paguar kompensimin prej 10% për trasenë e plotë të trenit;
- Prej një jave deri në 6 orë para realizimit duke paguar kompensimin prej 20% për trasenë e trenit të plotë; dhe

- më pak se 6 orë para realizimit të shërbimit duke paguar kompensimin e plotë 100% të trasesë së trenit.

Operatori hekurudhor është i obliguar që anulimin e kapaciteteve të alokuara ta paraqes me shkrim (përmes postës elektronike) në adresë të INFRAKOS-it:

18.4 Menaxheri i Infrastrukturës (INFRAKOS) për shkak të punëve të paplanifikuara mund ta anulojë trasenë e ndarë për **"Emri i operatorit të transportit"**:

- tre muaj para realizimit të shërbimit pa kompensim;
- prej 3 muajve deri në një javë para realizimit të shërbimit duke paguar kompensimin prej 10% për trasenë e plotë të trenit;
- Prej një jave deri në 6 orë para realizimit duke paguar kompensimin prej 20% për trasenë e trenit të plotë; dhe
- më pak se 6 orë para realizimit të shërbimit duke paguar kompensimin e plotë 100% të trasesë së trenit.

18.5 Në rastet kur anulimi i trenave të udhëtarëve dhe mallrave, apo vonesës së tyre e cila ndodhë për shkak të rasteve të jashtëzakonshme – fuqisë madhore, atëherë asnjëra palë nuk ka obligim që të bënë kompensimin e anulimit apo të vonesës së trenave.

## **VIII. Zëvendësimi (supstituimi) i trenave të udhëtarëve**

### **Neni 19**

19.1 Menaxheri i Infrastrukturës – INFRAKOS është i obliguar që të bënë organizimin dhe t'i bartë shpenzimet e zëvendësimit të transportit të udhëtarëve me autobus dhe të përgjigjet për vonesën e trenave të shkaktuar për shkak të zëvendësimit, në rastet kur Operatori i Transportit – **"Emri i operatorit të transportit"** nuk mundet ta shfrytëzon trasenë e ndarë për shkak të punëve të pa planifikuara në infrastrukturën hekurudhore. Në këtë rast Operatori i Transportit – **"Emri i operatorit të transportit"** është i obliguar që të paguaj trasenë e trenit sikurse të mos kishte ndodhur zëvendësimi.

19.2 Operatori i Transportit – **"Emri i operatorit të transportit"** është i obliguar që të bënë organizimin dhe t'i bartë shpenzimet e zëvendësimit të transportit të udhëtarëve me autobus dhe të përgjigjet për vonesën e trenave të shkaktuar për shkak të zëvendësimit, në rastet kur **"Emri i operatorit të transportit"** është përgjegjës për ç'rregullimet në komunikacion, respektivisht nuk mundet ta shfrytëzon trasenë e ndarë të infrastrukturën hekurudhore. Operatori i Transportit – **"Emri i operatorit të transportit"** është i obliguar që të paguaj trasenë e trenit sikurse të mos kishte ndodhur zëvendësimi.

19.3 Operatori i Transportit – **"Emri i operatorit të transportit"** është përgjegjës për vonesën e trenave të shkaktuar për shkak të zëvendësimit të mjeteve

lëvizëse të parapara me orarin e lëvizjes së trenave me mjete lëvizëse jo të përshtatshme.

19.4 Menaxheri i Infrastrukturës – INFRAKOS është i obliguar që të bëjë kompensimin e RIV-it të vagonëve të mallrave të cilët mund të presin të plotë dhe të zbrazet brenda territorit të Hekurudhave të Kosovës në rastet kur Operatori i Transportit – “Emri i operatorit të transportit” nuk mundet ta shfrytëzon trasenë e ndarë sipas paragrafit 18.4 të kësaj marrëveshjeje. Llogaritja e RIV-it bëhet në orë dhe çmimin në orë i cili është i rregulluar sipas kontratave të nënshkruara të “Emri i operatorit të transportit” me klientë.

19.5 Kompensimi për vonesën e trenave nga ky nen, llogaritet sipas Shtojcës 6 të kësaj marrëveshjeje.

## **IX. Informatat e ndërsjella**

### **Neni 20**

20.1 Palët e marrëveshjes në bazë të akteve në fuqi dhe pa vonesë do ta informojnë njëra tjetrën për ndryshimet të cilat kanë ndikim në kryerjen e transportit, në veçanti nëse këto ndryshime kanë të bëjnë me shmangien nga trasetë e alokuara, si dhe për rastet të cilat mund të ndikojnë në sigurinë e komunikacionit, gjendjen e infrastrukturës apo të shkaktojnë dëme në ambient, njerëz ose mjetet lëvizëse hekurudhore.

20.2 Palët e marrëveshjes do të emërojnë personat të cilët janë përgjegjës për realizimin e detyrimeve nga paragrafi 1 i këtij neni. Lista e personave të përcaktuar për këtë çështje është paraqitur në Shtojcën 5 të kësaj marrëveshjeje.

## **X. Rastet e jashtëzakonshme**

### **Neni 21**

21.1 Menaxheri i Infrastrukturës – INFRAKOS, respektivisht Operatori i Transportit – “Emri i operatorit të transportit”, në rastet e jashtëzakonshme do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të njerëzve, pengimin e shkakimit të mëtejme të dëmit dhe normalizimin e komunikacionit.

21.2 Palët në pajtim me njëra tjetrën do të përcaktojnë masat e caktuara për zvogëlimin e dëmit të shkakuar.

21.3 Secila nga palët përgjegjëse është e obliguar që t’i caktojë personat të cilët pala tjetër përgjegjëse duhet t’i lajmëron nëse ndodhë rasti i jashtëzakonshëm, e të cilët janë të autorizuar që të vendosin lidhur me masat nga paragrafi 21.2 i këtij neni

21.4 Lista e emrave të personave , respektivisht vendeve të punës përgjegjëse për këtë çështje është paraqitur në Shtojcën 5 të kësaj marrëveshjeje.

## **XI. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar gjatë transportit**

### **Neni 22**

22.1 Bazuar në rregulloret e përgjithshme dhe të veçanta mbi përgjegjësinë, Menaxheri i Infrastrukturës – INFRAKOS, do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar në mjetet lëvizëse të cilat i shfrytëzon Operatori i Transportit – “Emri i operatorit të transportit” dhe për pronën tjetër të Operatorit të Transportit, për dëmin në mallrat të cilat janë duke u transportuar, si dhe për dëmin të cilin e pësojnë punonjësit e Operatorit të Transportit dhe palët e treta; nëse për këtë janë fajtorë veprimet apo lëshimet e punonjësve të infrastrukturës.

22.2 Sipas rregulloreve të përgjithshme dhe të veçanta mbi përgjegjësinë, Operatori i Transportit – “Emri i operatorit të transportit”, do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar në infrastrukturë dhe pronën tjetër të Menaxheri i Infrastrukturës, për dëmin të cilin e pësojnë punonjësit e Menaxherit të Infrastrukturës dhe palët e treta; nëse për këtë janë fajtorë mjetet lëvizëse të cilat i shfrytëzon Operatori i Transportit si dhe veprimet apo lëshimet e punonjësve të Operatorit të Transportit.

### **Neni 23**

23.1 Bazuar në rregulloret e përgjithshme dhe të veçanta mbi përgjegjësinë, Menaxheri i Infrastrukturës – INFRAKOS, do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar në mjetet lëvizëse të cilat i shfrytëzon Operatori i Transportit – “Emri i operatorit të transportit” dhe për dëmin në personat dhe mallrat të cilat janë duke u transportuar, nëse për këtë është fajtorë pala e tretë me të cilën ka marrëdhënie kontraktuale INFRAKOS-i dhe dëmi vjen si pasojë e veprimeve apo lëshimeve të kësaj pale në infrastrukturë. Në këtë rast Menaxheri i Infrastrukturës – INFRAKOS ka të drejtën e kërimit të regresit ndaj palës së tretë për shkaktimin e dëmit.

23.2 Sipas rregulloreve të përgjithshme dhe të veçanta mbi përgjegjësinë, Operatori i Transportit – “Emri i operatorit të transportit”, do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar në infrastrukturë dhe pronën tjetër të Menaxheri i Infrastrukturës, nëse për këtë është fajtorë pala e tretë e cila është në marrëdhënie kontraktuale me “Emri i operatorit të transportit” dhe dëmi vjen si pasojë e veprimeve apo lëshimet të palës së tretë. Operatori i Transportit – “Emri i operatorit të transportit” ka të drejtën e kërimit të regresit ndaj palës së tretë për shkaktimin e dëmit.

23.3 Për dëmet e shkaktuara në infrastrukturë nga operimi me trena si pasojë e të cilave bëhet ndërprerja e shkurtër e komunikacionit dhe pasojnë dëmet materiale siç janë prerja e ndërruesve, dëmtimi i shinave, dëmtimi i traversave, dëmtimi i pjesëve tjera të infrastrukturës, apo dëmtimi i mjeteve lëvizëse; atëherë komisioni i përbashkët i të dy kompanive e bënë përcaktimin e fajtorit dhe vlerësimin e dëmit për të cilin dëm palët do ta bëjnë pagesën sipas kësaj marrëveshjeje.

#### **Neni 24**

Palët e marrëveshjes nuk kanë përgjegjësi nëse rasti i jashtëzakonshëm ndodhë për shkak të forcës madhore.

#### **Neni 25**

Greva është jashtë ndikimit të palëve të marrëveshjes. Në rast të grevës palët e marrëveshjes nuk janë të obliguara që t'i sigurojnë kushtet e përshkruara në këtë marrëveshje të cilat janë të ndërlidhura me zhvillimin e transportit hekurudhor.

### **XII. Dispozitat tjera**

#### **Verifikimi i korrektësisë**

#### **Neni 26**

26.1 Menaxheri i Infrastrukturës – INFRAKOS mund të kërkojë që të bëhet testimi i parkut lëvizës të cilin e përdorë Operatori i Transportit – “Emri i operatorit të transportit”, nëse dyshon se parku lëvizës e cenon sigurinë e komunikacionit hekurudhor dhe që e ka shkaktuar apo mund të shkaktojë dëmtimin e infrastrukturës.

26.2 Operatori i Transportit – “Emri i operatorit të transportit” mund të kërkojë që të bëhet testimi i infrastrukturës hekurudhore nëse dyshon se infrastruktura hekurudhore e cenon sigurinë e komunikacionit hekurudhor dhe që e ka shkaktuar apo mund të shkaktojë dëmtimin e parkut lëvizës.

26.3 Testimet sipas paragrafit 26.1 dhe 26.2 të këtij neni duhet të bëhen në atë mënyrë që të pengojnë sa më pak që të jetë e mundur zhvillimin e transportit hekurudhor.

26.4 Nëse testimi tregon se infrastruktura hekurudhore, respektivisht parku lëvizës i plotësojnë kriteret sipas nenit 8 dhe nenit 16 të kësaj marrëveshjeje, atëherë pala e cila e ka kërkuar testimin do t'i bartë shpenzimet e shkaktuara për shkak të testimit.

## Ndalimi i qarkullimit të trenave

### Neni 27

27.1 Palët e marrëveshjes kanë të drejtë dhe obligim që të bëjnë ndalimin e lëvizjes së trenave nëse sipas vlerësimit të tyre ekziston rreziku i pasojave eventuale për zhvillim të sigurt të komunikacionit, përveç për rastet kur ndalimi i lëvizjes së trenave do të shkaktonte dëm më të madh sesa qarkullimi i tyre.

27.2 Palët e marrëveshjes do ta mundësojnë vazhdimin e lëvizjes së trenave menjëherë pas ndërprerjes së arsyes së ndalim qarkullimit.

### XIII. Dispozitat përfundimtare

## Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e marrëveshjes

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dyja palët me kusht që **"Emri i operatorit të transportit"** ta ketë plotësuar obligimin sipas nenit 15, paragrafit 15.1 të kësaj marrëveshjeje dhe vlen për kohëzgjatjen e orarit të lëvizjes së trenave 2016/2017, ndërsa do të zbatohet nga data 11.12.2016 deri më datën 09.12.2017.

## Menaxherët e marrëveshjes

### Neni 29

Të dyja palët do të caktojnë menaxherët e marrëveshjes të cilët e kanë për detyrë të bëjnë menaxhimin e kësaj marrëveshjeje.

◆ Për INFRAKOS-in:

Emri dhe mbiemri, Menaxher i Sektorit të Komunikacionit  
Tel. 0000000000, mob. 0000000000  
Email. xxxxxxxxxxxx@kosovorailway.com

◆ Për "Emri i operatorit të transportit":

Tel. xxxxxxxxxxxx, mob. xxxxxxxxxxxxxx  
Email. xxxxxxxxx@xxxxxxxxxxxx

Secili menaxher kontraktues mund të emërojë zyrtarë për delegimin e çështjeve specifike. Informatat do t'i jepen palës tjetër përmes njoftimit me shkrim.

Në rast të ndërrimit të menaxherit kontraktues në njërën prej kompanive, KE i kompanisë ku ka ndodhur ndërrimi, do të njoftojë palën tjetër brenda 10 ditëve

të punës me një njoftim me shkrim duke propozuar edhe menaxherin tjetër të marrëveshjes.

### **Shkëputja e marrëveshjes Neni 30**

30.1 Në qoftë se ndonjëra nga palët i shkelë obligimet e kësaj marrëveshjeje, pala tjetër mund ta shkëpus pa vonesë marrëveshjen nëse pas tërheqjes së vërejtjes me shkrim dhe afatit të kuptueshëm të eliminimit të shkeljes, pala shkelëse nuk e ka hequr atë.

30.2 Nëse Operatori i Transportit – “Emri i operatorit të transportit” ia jep kapacitetin e ndarë të infrastrukturës ndonjë personi (kompanie) tjetër, atëherë Menaxheri i Infrastrukturës – INFRAKOS do ta shkëpusë menjëherë këtë marrëveshje dhe “Emri i operatorit të transportit” nuk do të ketë të drejtë të kërkoj kurrfarë dëmshpërblimi.

30.3 Kjo marrëveshje shkëputet në mënyrë automatike pas përfundimit të orarit të lëvizjes së trenave.

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve Neni 31**

31.1 Të gjitha mosmarrëveshjet eventuale të palëve nga kjo marrëveshje, palët do të tentojnë t'i zgjidhin së bashku. Në rast se palët nuk do të mundin t'i zgjedhin mosmarrëveshjet, atëherë përgjegjëse për zgjidhjen e tyre do të jetë gjykata kompetente në Prishtinë.

31.2 Në rast të mosmarrëveshjeve, për zgjidhjen e tyre do të zbatohen ligjet e Republikës së Kosovës.

### **Ndryshimet dhe plotësimet e marrëveshjes Neni 31**

Secili ndryshim eventual i kësaj marrëveshjeje do të bëhet në pajtim të plotë nga të dyja palët dhe do të verifikohet në mënyrë të shkruar.

### **Kopjet e marrëveshjes Neni 32**

Kjo marrëveshje është punuar dhe nënshkruar në katër kopje origjinale, nga dy kopje për secilën palë.

### **Shtojcat e marrëveshjes Neni 33**



Pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje janë edhe shtojcat në vijim:

- Shtojca 1 Përshkrimi i shërbimeve të cilat i ofron INFRAKOS-i
- Shtojca 2 Lista e traseve të cilat INFRAKOS-i ia ka ndarë "Emri i operatorit të transportit"
- Shtojca 3 Lista e akteve, udhëzimeve dhe rregulloreve të cilat janë në zbatim në INFRAKOS
- Shtojca 4 Modeli i llogaritjes së pagesave të qasjes në infrastrukturë
- Shtojca 5 Lista e personave përgjegjës për rastet e jashtëzakonshme
- Shtojca 6 Caktimi i shkaktarit dhe kompensimit për vonesën e trenave

Nënshkruar më 00.00.2016 në Fushë Kosovë

Kryeshefi Ekzekutiv i INFRAKOS-it

Z. Agron Thaçi

---

Kryeshefi Ekzekutiv i "Emri i operatorit të transportit"

Z. XXXXXXXXXXXXXXXX

---

**Shtojca 1 e marrëveshjes mbi qasjen në binarë  
Përshkrimi i shërbimeve të cilat i ofron INFRAKOS-i**

Me qëllim të realizimit të transportit në kapacitetet e alokuara të Infrastrukturës, ligjdhënësit Evropian i kanë definuar katër lloje të shërbimeve të cilat operatorët hekurudhor mund t'i shfrytëzojnë.

Shërbimet e ofruara nga Infrakosi janë në harmoni me dispozitat e Ligjit mbi hekurudhat nr. 04/L-063 për:

- qasje minimale të shërbimeve në pako;
- qasje në linjë deri te pajisjet shërbyese dhe shfrytëzimi i tyre;
- shërbimet shtesë; dhe
- shërbimet përcjellëse.

Menaxheri i Infrastrukturës Hekurudhore – INFRAKOS e bënë ofrimin e të gjitha shërbimeve të cilat janë përshkruar në Kapitullin e pestë të Ekspozeut të Rrjetit 2015.

Ofrimi i këtyre shërbimeve për "Emri i operatorit të transportit" do të bëhet në mënyrë korrekte dhe në vazhdimësi gjatë tërë periudhës së kohëzgjatjes së kësaj marrëveshjeje

## Shtojca 2 e marrëveshjes mbi qasjen në binarë

Lista e traseve të cilat INFRAKOS-i ia ka ndarë "Emri i operatorit të transportit"

[illegible]

[illegible]

**Shtojca 3 e marrëveshjes mbi qasjen në binarë**  
**Lista e akteve, udhëzimeve dhe rregulloreve të cilat janë në zbatim në**  
**INFRAKOS**

**Lista e akteve, udhëzimeve dhe rregulloreve të cilat janë në zbatim në INFRAKOS**

[illegible]

**Shtojca 4 e marrëveshjes mbi qasjen në binarë**  
**Modeli i llogaritjes së pagesave të qasjes në infrastrukturë**

Shih kapitullin e 6 (gjashtë) të Ekspozeut të Rrjetit për vitin 2017. Në këtë shtojcë në Marrëveshjen mbi qasjen në binarë në momentin e nënshkrimit të sajë nga INFRAKOS-i dhe operatori i transportit futet komplet kapitulli 6 (gjashtë) i ER 2017.

**Shtojca 5 e marrëveshjes mbi qasjen në binarë**  
**Lista e personave përgjegjës për rastet e jashtëzakonshme**

| Nr.                                                             | Emri dhe mbiemri | Numri i telefonit | Email adresa |
|-----------------------------------------------------------------|------------------|-------------------|--------------|
| <b>Lista e personelit të INFRAKOS-it</b>                        |                  |                   |              |
| 1                                                               |                  |                   |              |
| 2                                                               |                  |                   |              |
| 3                                                               |                  |                   |              |
| 4                                                               |                  |                   |              |
| 5                                                               |                  |                   |              |
| 6                                                               |                  |                   |              |
| 7                                                               |                  |                   |              |
| 8                                                               |                  |                   |              |
| <b>Lista e personelit të "Emri i operatorit të transportit"</b> |                  |                   |              |
| 1                                                               |                  |                   |              |
| 2                                                               |                  |                   |              |
| 3                                                               |                  |                   |              |
| 4                                                               |                  |                   |              |
| 5                                                               |                  |                   |              |
| 6                                                               |                  |                   |              |
| 7                                                               |                  |                   |              |
| 8                                                               |                  |                   |              |

Për ndryshimet eventuale të këtyre listave, palët obligohen që paraprakisht ta njoftojnë njëra tjetrën.

## **Shtojca 6 e marrëveshjes mbi qasjen në binarë Caktimi i shkaktarit dhe kompensimit për vonesën e trenave**

Varësisht nga rastet, vonesat e trenave ndahen në vonesa primare dhe vonesa sekondare. Në linjat e menaxhuara nga INFRAKOS do të llogariten vetëm vonesat primare.

Shembujt e vonesave primare për të cilat përgjigjet Menaxheri i Infrastrukturës janë vonesat e shkaktuara për arsye të:

- Shpejtësive të ngadalësuara;
- Mbylljes të pa planifikuar të linjës hekurudhore për arsye të punimeve në Infrastrukturë;
- Pengesave në pajisjet sinjalo – siguruese; dhe
- Rasteve të jashtëzakonshme me fajin e Infrastrukturës.

Shembujt e vonesave primare për të cilat përgjigjet Operatori i Transportit janë vonesat e shkaktuara për arsye të:

- Vazhdimet të lëvizjes së trenave për arsye të tërheqjes;
- Vonësive për arsye të përbërjes së trenit, garniturës ose lokomotivës;
- Defektit të lokomotivës;
- Defektit të vagonit; dhe
- Rasteve të jashtëzakonshme me fajin e Trainkosit.

Menaxheri i Infrastrukturës për rastet e jashtëzakonshme e përcakton se a ka qenë Infrakosi apo Trainkosi fajtor për vonesat primare. Rastet tjera të vonesave konsiderohen si sekondare dhe për këto nuk bëhet përlllogaritje.

Shkakun e vonesës e përcakton Menaxheri i Infrastrukturës. Nëse operatori i transportit mendon se shkakun e vonesës nuk është caktuar drejt, ai në afat prej 10 ditësh prej ditës kur e ka marrë shënimin e ka të drejtën e paraqitjes së kundërshtimit me shkrim te Menaxheri i Infrastrukturës. Të gjitha kundërshtimet shqyrtohen në afat prej 1 (një) muaji nga një përfaqësues i Infrakosit dhe një përfaqësues i "Emri i operatorit të transportit". Vendimi i përfaqësuesve për arsyet e vonesave është përfundimtar.

Kompensimet për vonesa llogariten sipas minutave të vonesës për çdo tren veçmas. Kompensimet për vonesa janë 0.1% nga traseja e plotë e trenit për një minutë të vonesës. Kompensimi për vonesa të një treni mund të jetë maksimalisht 5% nga çmimi i përgjithshëm i një traseje të trenit.



**Shtojca 1.2: Distanca në mes të vendeve zyrtare dhe shpejtësia më e madhe e lejuar**

| Emërtimi i stacionit<br>- segmentit të<br>linjës hekurudhore | Shifra | Pozita kilometrike | Statusi | Gjatësia e<br>segmenteve | Gjatësia në mes<br>stacioneve | Gjatësi e linjës | Vmax |
|--------------------------------------------------------------|--------|--------------------|---------|--------------------------|-------------------------------|------------------|------|
| 1                                                            | 2      | 3                  | 4       | 5                        | 6                             | 7                | 8    |
| <b>Linja 1: Kufiri- Leshak- Fushë Kosovë</b>                 |        |                    |         |                          |                               |                  |      |
| Leshak kufiri                                                |        | 164+4              |         |                          |                               | 82.4             | 60   |
| Leshak kufi-Leshak                                           |        |                    |         |                          | 7.9                           |                  |      |
| Leshak                                                       |        | 172.3              | 01      |                          |                               |                  |      |
| Leshak- Dren                                                 |        |                    |         | 5.6                      |                               |                  |      |
| Dren v.ç                                                     |        | 177.9              | 03      |                          | 10.5                          |                  |      |
| Dren- Leposaviq                                              |        |                    |         | 4.9                      |                               |                  |      |
| Leposaviq                                                    |        | 182.8              | 01      |                          |                               |                  |      |
| Leposaviq-Soqanicë                                           |        |                    |         | 5.7                      |                               |                  |      |
| Soqanicë                                                     |        | 188.5              | 03      |                          | 9.5                           |                  |      |
| Soqanicë- Sllatina e Ibrit                                   |        |                    |         | 3.8                      |                               |                  |      |
| Sllatina e Ibrit                                             |        | 192.3              | 01      |                          |                               |                  |      |
| Sllatina e Ibrit- Pllandishtë                                |        |                    |         | 2.4                      |                               |                  |      |
| Pllandishtë                                                  |        | 195..7             | 03      |                          | 18.6                          |                  |      |
| Pllandishtë- Banja                                           |        |                    |         | 6.3                      |                               |                  |      |
| Banja                                                        |        | 202.0              | 02      |                          |                               |                  |      |
| Banja -Vallaq                                                |        |                    |         | 6.2                      |                               |                  |      |
| Vallaq                                                       |        | 20.2               | 03      |                          |                               |                  |      |
| Vallaq-Zveqan                                                |        |                    |         | 2.7                      |                               |                  |      |
| Zveqan                                                       |        | 210.9              | 01      |                          |                               |                  |      |
| Zveqan-Mitrovicë                                             |        |                    |         | 3.5                      |                               |                  |      |
| Mitrovicë                                                    |        | 214.4              | 01      |                          | 3.5                           |                  |      |
| Mitrovicë- Frashër                                           |        |                    |         | 5.0                      |                               |                  |      |
| Frashër                                                      |        | 219.4              | 03      |                          |                               |                  |      |
| Frashër- Pantina                                             |        |                    |         | 1.9                      |                               |                  |      |
| Pantina                                                      |        | 221.3              | 03      |                          | 9.4                           |                  |      |
| Pantina -Vushtrri                                            |        |                    |         | 2.5                      |                               |                  |      |
| Vushtrri                                                     |        | 223.8              | 01      |                          |                               |                  |      |
| Vushtrri- Vërrinë                                            |        |                    |         | 5.0                      |                               |                  |      |
| Vërrinë                                                      |        | 228.8              | 03      |                          |                               |                  |      |
| Vërrinë-Druar                                                |        |                    |         | 2.1                      |                               |                  |      |

|                                           |  |       |    |      |      |        |    |
|-------------------------------------------|--|-------|----|------|------|--------|----|
| Druar                                     |  | 230.9 | 03 |      | 12.6 |        |    |
| Druar- Mirash                             |  |       |    | 2.3  |      |        |    |
| Mirash                                    |  | 233.2 | 03 |      |      |        |    |
| Mirash-Përlluzhë                          |  |       |    | 3.2  |      |        |    |
| Përlluzhë                                 |  | 236.4 | 01 |      |      |        |    |
| Përlluzhë-Analumi                         |  |       |    | 3.4  |      |        |    |
| Analumi                                   |  | 239.8 | 03 |      |      |        |    |
| Analumi-Kastriot                          |  |       |    | 2.9  |      |        |    |
| Kastriot                                  |  | 242.7 | 01 |      | 6.1  |        |    |
| Kastrot- Dardhishtë                       |  |       |    | 2.2  |      |        |    |
| Dardhishtë                                |  | 244.9 | 03 |      |      |        |    |
| Dardhishtë- Fushë Kosovë                  |  |       |    | 3.9  |      |        |    |
| Fushë Kosovë                              |  | 248.8 | 01 |      |      |        |    |
| Linja 2: Fushë Kosovë –Hani Elezit kufiri |  |       |    |      |      |        |    |
| Fushë Kosovë                              |  | 248.8 | 01 |      | 2.6  | 64.100 | 70 |
| Fushë Kosovë- Miradi                      |  |       |    | 2.6  |      |        |    |
| Miradi                                    |  | 251.4 | 01 |      | 10.5 |        |    |
| Miradi- Hashanaj                          |  |       |    | 7.3  |      |        |    |
| Hashanaj                                  |  | 258.7 | 03 |      |      |        |    |
| Hashanaj - Lypian                         |  |       |    | 3.2  |      |        |    |
| Lypian                                    |  | 261.9 | 01 |      | 9.3  |        |    |
| Lypian-Fushlot                            |  |       |    | 5.0  |      |        |    |
| Fushlot                                   |  | 266.9 | 03 |      |      |        |    |
| Fushlot-Bablak                            |  |       |    | 4.3  | 10.3 |        |    |
| Bablak                                    |  | 271.2 | 01 |      |      |        |    |
| Bablak-Kodrion                            |  |       |    | 3.8  |      |        |    |
| Kodrion                                   |  | 275.0 | 03 |      | 8.0  |        |    |
| Kodrion-Ferizaj                           |  |       |    | 6.5  |      |        |    |
| Ferizaj                                   |  | 281.5 | 01 |      | 10.5 |        | 60 |
| Ferizaj-Gurëz                             |  |       |    | 8.0  |      |        |    |
| Gurëz                                     |  | 289.5 | 01 |      |      |        |    |
| Gurëz- Kaçaniku i vjetër                  |  |       |    | 1.9  |      |        |    |
| Kaçaniku i vjetër                         |  | 291.4 | 03 |      |      |        |    |
| Kaçaniku i vjetër- Stagona                |  |       |    | 3.2  |      |        |    |
| Stagona                                   |  | 294.6 | 03 |      |      |        |    |
| Stagona- Kaçaniku                         |  |       |    | 5.4  | 11.6 |        |    |
| Kaçaniku                                  |  | 300.0 | 01 |      |      |        |    |
| Kaçaniku- Hani Elezit                     |  |       |    | 11.6 |      |        |    |
| Hani Elezit                               |  | 311.6 | 01 |      | 1.3  |        |    |
| Hani Elezit - Kufiri                      |  |       |    | 1.3  |      |        |    |
| Kufiri                                    |  | 312.9 |    |      |      |        |    |

| Linja 3: Fushë Kosovë- Pejë |  |      |    |     |      |     |
|-----------------------------|--|------|----|-----|------|-----|
| Fushë Kosovë                |  | 0.0  | 01 |     |      | 6.0 |
| Fushë Kosovë- Bardh         |  |      |    | 6.0 |      |     |
| Bardh                       |  | 6.0  | 01 |     |      |     |
| Bardh- Mjekaj               |  |      |    | 4.9 | 16,5 | 60  |
| Mjekaj                      |  | 10.9 | 03 |     |      |     |
| Mjekaj-Dritan               |  |      |    | 4.6 |      |     |
| Dritan                      |  | 15.5 | 03 |     |      |     |
| Dritan-Drenas               |  |      |    | 7.0 |      |     |
| Drenas                      |  | 22.5 | 01 |     | 32.6 |     |
| Drenas-Domanek              |  |      |    | 4.1 |      |     |
| Domanek                     |  | 26.6 | 03 |     |      |     |
| Domanek- Lugdren            |  |      |    | 2.9 |      |     |
| Lugdren                     |  | 29.5 | 03 |     |      |     |
| Lugdren-Gurkas              |  |      |    | 3.6 |      |     |
| Gurkas                      |  | 33.1 | 03 |     |      |     |
| Gurkas- Qarrat              |  |      |    | 3.8 |      |     |
| Qarrat                      |  | 36.9 | 03 |     |      |     |
| Qarrat-Aqarevë              |  |      |    | 3.9 |      |     |
| Aqarevë                     |  | 40.8 | 03 |     |      |     |
| Aqarev-Ujëmir               |  |      |    | 3.0 |      |     |
| Ujmir                       |  | 43.8 | O2 |     |      |     |
| Ujmir-Gurkat                |  |      |    | 5.6 |      |     |
| Gurkat                      |  | 49.4 | 03 |     |      |     |
| Gurkat- Klinë               |  |      |    | 5.7 |      |     |
| Klinë                       |  | 55.1 | 01 |     | 26.1 |     |
| Klinë- Shëngjergj           |  |      |    | 4.9 |      |     |
| Shëngjergj                  |  | 60.0 | 03 |     |      |     |
| Shengjergj-Budisals         |  |      |    | 4.9 |      |     |
| Budisals                    |  | 64.9 | 02 |     |      |     |
| Budisals-Arbanë             |  |      |    | 5.4 |      |     |
| Arbanë                      |  | 70.3 | 03 |     |      |     |
| Arbanë-Separant             |  |      |    | 3.8 |      |     |
| Seperant                    |  | 74.1 | 03 |     |      |     |
| Seperant-Pejë               |  |      |    | 7.1 |      |     |
| Pejë                        |  | 81.2 | 01 |     |      |     |
| Linja 3a: Klinë- Prizren    |  |      |    |     |      |     |
| Klinë                       |  | 0.0  | 01 |     | 50   |     |
| Klinë-Mirushë               |  |      |    | 8.2 |      |     |
| Mirushë                     |  | 8.2  |    |     |      |     |
| Mirushë- Vollujak           |  |      |    | 4.7 |      |     |
| Vollujak                    |  | 12.9 |    |     |      |     |
| Km 13+                      |  |      |    |     |      |     |
| Vallujak- Kramovik          |  |      |    | 5.4 |      |     |
| Kramovik                    |  | 18.3 |    |     |      |     |

|                                                 |  |       |    |      |      |                      |    |
|-------------------------------------------------|--|-------|----|------|------|----------------------|----|
| Kramovik- Qifllak                               |  |       |    | 3.7  | 35.0 |                      |    |
| Qifllak                                         |  | 22.0  |    |      |      | 58.300               |    |
| Qifllak- Balldri                                |  |       |    | 5.3  |      |                      |    |
| Ballori                                         |  | 27.3  |    |      |      |                      |    |
| Balldri- Xërxe                                  |  |       |    | 8.0  |      |                      |    |
| Xërxe                                           |  | 35.3  | 01 |      |      |                      |    |
| Xërxe- Bajram Curr                              |  |       |    | 9.6  |      |                      |    |
| Bajram Curr                                     |  | 44.9  |    |      | 23.0 | Jashtë<br>përdorimit |    |
| Bajram Curr-Prizren                             |  |       |    | 13.4 |      |                      |    |
| Prizren                                         |  | 58.3  |    |      |      |                      |    |
| <b>Linja 4: Fushë Kosovë – Besianë - kufiri</b> |  |       |    |      |      |                      |    |
| Fushë Kosovë                                    |  | 129.6 | 01 |      |      |                      |    |
| Fushë Kosovë-<br>Prishtinë                      |  |       |    | 6.7  | 6.7  | 14,6                 | 50 |
| Prishtinë                                       |  | 122.9 | 01 |      |      |                      |    |
| Prishtinë-Bardhosh                              |  |       |    | 7.9  |      |                      | 30 |
| Bardhosh                                        |  | 115.0 |    |      | 7.9  |                      |    |
| Bardhosh- Vranesh                               |  |       |    | 7.4  |      |                      |    |
| Vranesh                                         |  | 107.6 |    |      |      |                      |    |
| Vranesh- Kulinë                                 |  |       |    | 3.5  |      |                      |    |
| Kulinë                                          |  | 104.1 |    |      |      |                      |    |
| Kulinë- Penuh                                   |  |       |    | 3.6  |      |                      |    |
| Penuh                                           |  | 100.5 |    |      | 24.3 | Jashtë<br>përdorimit |    |
| Penuh-Dumosh                                    |  |       |    | 4.4  |      |                      |    |
| Dumosh                                          |  | 96.1  |    |      |      |                      |    |
| Dumosh-Besian                                   |  |       |    | 5.4  |      |                      |    |
| Besian                                          |  | 90.7  |    |      |      |                      |    |
| Besian -Kufiri                                  |  |       |    |      |      |                      |    |
| Kufiri                                          |  |       |    |      |      |                      |    |
| Bardh - Medvec                                  |  | 11    |    | 11   |      |                      |    |

- Shifra (statusi) 01 - vend zyrtar stacion i zotëruar me personel  
 Shifra (statusi) 02 - vend zyrtar , stacion i pa zotëruar  
 Shifra (statusi) 03 - vend zyrtar- pikë për ndalje të trenave të udhëtarëve në  
 linjën e hapur hekurudhore

## Shtojca 1.3: Gjatësia më e madhe e lejuar e trenave në stacione

| Emërtimi i stacionit                          | Drejtimi A - B                               |                                               | Drejtimi B - A                               |                                               |
|-----------------------------------------------|----------------------------------------------|-----------------------------------------------|----------------------------------------------|-----------------------------------------------|
|                                               | Gjatësia më e madhe e lejuar e trenit në(m). | Binarët më të gjatë për pranim të trenave (m) | Gjatësia më e madhe e lejuar e trenit në (m) | Binarët më të gjatë për pranim të trenave (m) |
| <b>1. Linja 1: Leshak-Fushë Kosovë</b>        |                                              |                                               |                                              |                                               |
| Leshak                                        | 479                                          | 2                                             | 473                                          | 2                                             |
| Leposaviq                                     | 521                                          | 2                                             | 516                                          | 2                                             |
| Sllatina e Ibrit                              | 507                                          | 2                                             | 500                                          | 2                                             |
| Zveqan                                        | 493                                          | 1                                             | 492                                          | 1                                             |
| Mitrovicë                                     | 630                                          | 3                                             | 640                                          | 3                                             |
| Vushtrri                                      | 506                                          | 3                                             | 508                                          | 3                                             |
| Prilluzhë                                     | 504                                          | 2                                             | 504                                          | 2                                             |
| Kastriot                                      | 480                                          | 3                                             | 481                                          | 3                                             |
